BASHKIA SHKODËR

# P.6 Zhvillimi ekonomik lokal dhe turizmit

**"Zhvillimin Lokal të Udhëhequr nga Komuniteti për të mobilizuar dhe përfshirë komunitetet dhe organizatat lokale për të kontribuar në arritjen e qëllimeve për rritje të zgjuar, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse dhe duke nxitur kohezionin territorial"**

**Përmbajtja**

P6. Zhvillimi ekonomik lokal dhe turizmit 3
1. Hyrje 3
2. Politikat e zhvillimit 4
3. Funksionet: 5
3.1 F1. Hartimi i planeve dhe programeve për zhvillimin ekonomik lokal 5
3.1.1 Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F1.O1 5
3.2 F2. Ngritja dhe funksionimi i tregjeve publike dhe i rrjetit të tregtisë 5
3.2.1 Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F2.O1. 6
3.3 F3. Mbështetje për zhvillimin e biznesit të vogël nëpërmjet veprimtarive nxitëse, të tilla si panaire e reklama në vende publike 6
3.3.1 Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F3.O1. 7
3.4 F4. Publikimi i broshurave informative, krijimit të portaleve me profil ekonomik 7
3.4.1 Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F4.O1. 7
3.5 F5. Dhënia e granteve dhe ndihmave financiare për mbështetjen e aktiviteteve të biznesit të vogël dhe të mesëm, sipas mënyrës së përcaktuar në legjislacionin në fuqi 7
3.5.1 Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F5.O1. 8
3.6 F6 Zhvillimi i Turizmit 8
3.6.1 Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F6.O1 9
3.6.2 Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F6.O2. 9
3.6.3 Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F6.O3 10
3.6.4 Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F6.O4 10
3.6.5 Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F6.O5 11
3.6.6 Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F6.O6 11
3.6.7 Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F6.O7. 12
4. Buxhetimi i programit të Zhvillimi ekonomik lokal dhe turizmit 12
5. Projektet dhe aktivitetet e planifikuara për zhvillimi ekonomik lokal dhe turizmit 14

## P6. Zhvillimi ekonomik lokal dhe turizmit

### 1. Hyrje

Bashkia Shkodër, në krahasim me organizimin e mëparshëm është rritur në hapësirë, ky ndryshim ka sjellë një rol të ri për zhvillimin dhe menaxhimin territorial. Në këtë situatë të re bëhet e domosdoshme përpjekja për të përcaktuar drejtimet që duhen ndjekur në të ardhmen duke u fokusuar dhe përdorur mirë burimet ekzistuese. Ndaj çështja kryesore është përkthimi i shumëllojshmërisë së avantazheve konkurruese në mundësi për investimet e huaja të cilat do të sjellin zhvillim social-ekonomik, duke bërë të mundur që çdo territor të kontribuojë në mirëqënien e Bashkisë.

Duke qënë se rritja ekonomike dhe hapja e vendeve të reja të punës në ekonomitë në zhvillim, varen nga dy faktorë kryesorë: tërheqja e investitorëve të huaj dhe zhvillimi i NVM-ve, Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës ka ndërmarrë disa nisma për forcimin e bashkëpunimit ndërmjet pushtetit vendor, bizneseve dhe punëkërkuesve, me qellim promovimin e forcës aktive të punës, promovimin e produkteve dhe shërbimeve të bizneseve sipas sektorëve të ndryshëm të ekonomisë.

Turizmi, si aktivitet ndërsektoral, është i lidhur me shumë aktivitete ekonomike me ndikim të jashtëzakonshëm në sektorë të ndryshëm, duke ofruar shërbime të lidhura me kohën e lirë dhe me udhëtimet e biznesit. Ai luan një rol të madh në zhvillim, pasi kontribuon në zhvillimin lokal, krijimin e vendeve të punës, zhvillimin e zonave në rënie industriale apo rurale, si dhe në rigjenerimin urban. Drejtoria e Turizmit, me një qasje të re në hartimin e politikave të zhvillimit të turizmit, ka trajtuar çështje kritike territoriale në mënyrë të koordinuar duke ruajtuar një vazhdimësi me programet sektorale të zhvillimit. Forcimi institucional nëpërmjet ngritjes së strukturave të dedikuara për përmirësimin e shërbimit ndaj vizitorit, përmirësimi i infrastrukturës turistike, organizimi i panaireve të atraksioneve dhe bizneseve turistike të rajonit, prodhimi i materialeve promocionale për territorin e ri të Bashkisë Shkodër, organizimi i një sërë aktivitetesh me qëllim ripërtëritjen e trashëgimisë kulturore dhe artistike. Bashkëpunimi me sektorin privat në marketingun e vlerave dhe potencialeve të territorit ka ndikuar në forcimin e identitetit të rajonit duke kontribuar në rritjen e shpenzimeve të turistëve dhe për rrjedhojë në rritjen e të ardhurave për territorin.

## 2. Politikat e zhvillimit

Programi i zhvillimit ekonomik lokal dhe i turizmit, bazohet në 8 politika themelore:

Zhvillimi Lokal i Udhëhequr nga Komuniteti
(Mobilizimi dhe përfshirja e komunitetit dhe organizatave lokale për të kontribuar në arritjen e qëllimeve të Strategjisë Europë 2020)

Investimet e Integruara Territoriale
(Aplikime me projekte konkrete në programe të ndryshme për zhvillimin e territorit).

Mbështetje për përmirësimin e kushteve për fillimin dhe zhvillimin e biznesit
(Ofrimi i shërbimeve të cilësisë së lartë, dhënie informacioni ligjor, fiskal, orientim bazuar në studimet zhvillimore të Bashkisë)

Rritja e aftësisë konkurruese të ndërmarrjeve
(Konkurrueshmëria në tregjet vendore dhe ndërkombëtare nëpërmjet inovacionit, zhvillimit dhe përkrahjes së markave rajonale, zhvillimit të zinxhirëve të vlerës dhe përmirësimit të sistemeve të shpërndarjes)

Zhvillimi i fuqisë punëtore të kualifikuar sipas kërkesave të tregut të punës
(Qëndrat e punësimit, programet e reja mësimore në arsimin profesional)

Industria e turizmit, burim kryesor i rritjes ekonomike
(Nëpërmjet promovimit aktiv të politikave, turizmi do të kthehet në një mjet për integrimin e territoreve më pak të zhvilluara dhe për përmirësimin e ruajtjen e zonave të trashëgimisë)

Zhvillimi i ekuilibruar dhe endogjen i turizmit
(Rritja e vlerës së territorit si destinacion turistik, duke forcuar identitetin e saj unik kulturor, social, mjedisor e ekonomik dhe burimet njerëzore)

Marketing i vlerave dhe potencialeve të komunitetit
(Kualifikim i punonjësve, rritje e cilësisë së shërbimit në fushën e turizmit)

Në kuadër të ligjit nr.139/2015 "Për qeverisjen Vendore" Bashkia Shkodër ka përgjegjësinë të punojë për kryerjen e funksioneve si më poshtë. Për periudhën 2018-2020, kemi objektiva të qartë për punën tonë në përmbushjen e detyrave funksionale. Në këtë kuadër politikat e zhvillimit të Bashkisë Shkodër do të jenë të fokusuara në zhvillimin e një ekonomie të gjallë sipas parimit të plotësueshmërisë ndërmjet qytetit dhe zonave rurale.

## 3. Funksionet:

### 3.1 F1. Hartimi i planeve dhe programeve për zhvillimin ekonomik lokal

**F1.O1. Mbështetja për përmiresimin e klimës për zhvillimin e biznesit nëpërmjet ngritjes së strukturave të dedikuara, bashkëpunimit me institucione të specializuara dhe aktorët e interesuar për hartimin e strategjive dhe planeve ekonomike zhvillimore lokale.**

**Situata e vleresuar/ pritshme në fund të vitit 2017:**

- Ngritja e Bordit te Zhvillimit Ekonomik
- Dokumenta strategjike
- Studimi për klasterat e biznesit që operojnë në Bashkinë Shkodër.
- Studimi për marketingun dhe brandimit e bisneseve të Bashkisë Shkodër.
- Studimi i fizibilitetit për menaxhimin e aseteve bashkiake.

Qëllimi i këtyre dokumentave është prezantimi i përmbledhur i të gjithë informacionit lidhur me territorin e ri të Bashkisë Shkodër, i cili prezanton potencialet dhe tendencat e zhvillimit të gjithë zonës.

| Situata e synuar 2018 | Situata e synuar 2019 | Situata e synuar 2020 |
|---|---|---|
| Një strategji dhe tre studime | | |
| Numri i projekteve 12 | Numri i projekteve 14 | Numri i projekteve 16 |

#### 3.1.1 Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F1.O1

| Aktiviteti | Buxheti në mijë lekë |
|---|---|
| **P6.F1.O1.A1.** Monitorimi dhe Vlerësimi i strategjise së zhvillimit të Bashkisë Shkodër | - |
| **P6.F1.O1.A3.** Hartimi i plan Bizneseve për menaxhimin e aseteve të Bashkisë Shkodër | - |
| **P6.F1.O1.A4.** Krijimi i instrumentit financiar për forcimin e kapaciteteve të OSHC-ve nëpërmjet aplikimeve në bazë projekti për ofrimin e shërbimeve cilësore në komunitet.(ReLOad) | 1,474 |
| **P6.F1.O1.A5.** Pjesmarrje në programet dhe projektet e financuara nga Bashkimi Europian dhe Organizata të tjera ndërkombëtare | |

### 3.2 F2. Ngritja dhe funksionimi i tregjeve publike dhe i rrjetit të tregtisë

**F2.O1 Sistemimi dhe ngritja e tregjeve të shitjes me shumicë dhe pakicë në territorin e Shkodrës.**

**Situata e vlerësuar/pritshme në fund të vitit 2017:**

- Rehabilitimi i sheshit Merkatës Rus.
- Rregullore e hartuar për funksionimin e tregjeve të lëvizshme.
- Tregje ditore të ngritura dhe funksionale.
- Mirëmbajtja e tregjeve ekzistuese.

| Situata e synuar 2018 | Situata e synuar 2019 | Situata e synuar 2020 |
|---|---|---|
| Rehabilitim i një tregu (Merkato Rus)<br>Ndërtimi i pesë tregjeve (tregje te levizshme)<br>230 vënde shitjeje në dispozicion të tregtarëve | Mirëmbajtje i tregut (Merkato Rus)<br>Ndërtimi i gjashtë tregjeve (tregje te levizshme dhe stacionare)<br>330 vënde shitjeje në dispozicion të tregtarëve | |

### 3.2.1 Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F2.O1.

| Aktiviteti | Buxheti në mijë lekë |
|---|---|
| **P6.F2.O1.A1.** Ndërtimi i tregut të shitjes me pakicë të produkteve agro-ushqimore lokale | - |
| **P6.F2.O1.A4.** Mirëmbajtje e tregjeve ekzistuese | |
| **P6.F2.O1.A5.** Tregu rajonal i peshkut | - |
| **P6.F2.O1.A6.** Tregu i produkteve bujqësore Velipojë | - |

## 3.3 F3. Mbështetje për zhvillimin e biznesit të vogël nëpërmjet veprimtarive nxitëse, të tilla si panaire e reklama në vende publike

**F3.O1. Promovimi i produkteve vendore dhe fuqisë së punonjësve të specializuar për tregun lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar**

**Situata e vlerësuar/pritshme në fund të vitit 2017:**

Organizimi i katër panaireve (dy qytet dhe dy në Nj.A.):
- Organizimi i një panairi pune dhe bizneseve prodhuese
- Organizimi i një panairi të produkteve agropërpunuese sipas njësive administrative
- Organizimi i Panairit të promovimit të vlerave dhe produkteve të territorit (për Njësitë Administrative, Guri i Zi dhe Ana e Malit)
- Organizimi i Panairit të promovimit të vlerave dhe produkteve të territorit (për Njësitë Administrative)

| Situata e synuar 2018 | Situata e synuar 2019 | Situata e synuar 2020 |
|---|---|---|
| Janë organizuar 12 panaire (dy në qytet dhe dhjetë në Nj. Administrative) | Janë organizua 12 panaire (dy në qytet dhe dhjetë në Nj. Administrative) | Janë organizua 12 panaire (dy në qytet dhe dhjetë në Nj. Administrative) |

### 3.3.1 Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F3.O1.

| Aktiviteti | Buxheti në mijë lekë |
|---|---|
| **P6.F3.O1.A1.** Organizimi i një panairi pune dhe bizneseve në Bashkinë Shkodër | 300 |
| **P6.F3.O1.A2.** Panairi i produkteve agropërpunuese sipas njësive administrative | 700 |
| **P6.F3.O1.A3.** Panair i promovimit të vlerave dhe produkteve të territorit (për Njësitë Administrative) | 1,440 |

## 3.4 F4. Publikimi i broshurave informative, krijimit të portaleve me profil ekonomik

**F4.O1. Hartimi dhe publikimi i materialeve informative dhe promocionale për nxitjen e investimeve vendase dhe të huaja**

**Situata e vlerësuar/pritshme në fund te vitit 2017:**

Numri i materialeve informative të publikuara/botuara për zhvillimin ekonomik
- Botimi i profilit të Bashkisë
- Botimi i profilit të bizneseve te Bashkisë Shkodër
- Informacion digjital i përditësuar në faqen web të Bashkisë së Shkodrës.

| Situata e synuar 2018 | Situata e synuar 2019 | Situata e synuar 2020 |
|---|---|---|
| Pesë publikime: 4 botime dhe informacion digjital i përditësuar në faqen web të Bashkisë së Shkodrës | Gjashtë publikime: 5 botime dhe informacion digjital i përditësuar në faqen web të Bashkisë së Shkodrës | Gjashtë publikime: 5 botime dhe informacion digjital i përditësuar në faqen web të Bashkisë së Shkodrës |

### 3.4.1 Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F4.O1.

| Aktiviteti | Buxheti në mijë lekë |
|---|---|
| **P6.F4.O1.A1.** Ribotimi i profilit te Bashkise | 400 |
| **P6.F4.O1.A2.** Ristrukturimi dhe pasurimi i faqes Web të Bashkisë | - |
| **P6.F4.O1.A3.** Ribotim i broshurës informative për tërheqjen e investimeve vendase dhe të huaja në Bashkinë Shkodër | 300 |

## 3.5 F5. Dhënia e granteve dhe ndihmave financiare për mbështetjen e aktiviteteve të biznesit të vogël dhe të mesëm, sipas mënyrës së përcaktuar në legjislacionin në fuqi

**F5. O1. Nxitja dhe mbështetja e bashkëpunimit të biznesit vendor, nëpërmjet incentivave financiar, për zhvillimin dhe fuqizimin e tyre**

**Situata e vlerësuar/pritshme në fund të vitit 2017:**

Numri i inisiativave të mbështetura dhe numri i bizneseve:
- Mbështetja e një inisiative për zhvillimin e zonave të permiresimit të biznesit
- Rreth 120 biznese përfituese,
- Përkrahja e inisiativës për ngritjen e Zonës së përmirësimit të biznesit

| Situata e synuar 2018 | Situata e synuar 2019 | Situata e synuar 2020 |
|---|---|---|
| Mbeshteten dy inisiativa për zhvillimin e zonave të permiresimit të biznesit. Rreth 200 biznese përfituese. Mbeshtetja e bisneseve në skemat e ndryshme financiare | Mbeshteten dy inisiativa për zhvillimin e zonave të permiresimit të biznesit. Rreth 200 biznese përfituese. Mbeshtetja e bisneseve në skemat e ndryshme financiare | Mbeshteten dy inisiativa për zhvillimin e zonave të permiresimit të biznesit. Rreth 200 biznese përfituese. Mbeshtetja e bisneseve në skemat e ndryshme financiare |

### 3.5.1 Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F5.O1.

| Aktiviteti | Buxheti në mijë lekë |
|---|---|
| **P6.F5.O1.A1.**Bashkëpunimi me Zonën e përmirësimit të biznesit (BID) në rrugën 13 Dhjetori dhe 28 Nëntori | 1,600 |
| **P6.F5.O1.A2.** Krijimi i Zonave të reja BID në Bashkinë Shkodër | - |
| **P6.F5.O1.A3.** Nxitja e investimeve në kërkim dhe zhvillim me qellim ngritjen e kompanive të reja (Start Up) dhe zhvillimin e SME-ve ekzistuese | - |
| **P6.F5.O1.A4.** Mbështetja dhe lehtësimi i bizneseve për aplikime në programet dhe skema të ndryshme financiare | - |

## 3.6 F6 Zhvillimi i Turizmit

**F6.O1 Promovim i territorit të Bashkisë nëpërmjet prodhimit dhe botimit të materialeve promocionale-informative.**

**Situata e vleresuar në fund të vitit 2017:**
Web site i dedikuar për turizmin i përditsuar i Bashkise Shkoder, aplikacion për smarphone me informacion turistik, guidë turistike e Bashkisë Shkodër e përditësuar. Hartë turistike, Kalendar i ngjarjeve kulturore.

| Situata e synuar 2018 | Situata e synuar 2019 | Situata e synuar 2020 |
|---|---|---|
| Web site i dedikuar për turizmin i përditësuar, aplikacion për smartphone me informacion turistik. Guidë turistike e Bashkisë Shkodër e përditësuar dhe e rikonceptuar në dy gjuhë. 3 harta turistike për destinacione të veçanta të territorit të Bashkisë, Kalendar i ngjarjeve kulturore I përditësuar. të paktën 3 botime | Web site i dedikuar për turizmin i përditësuar, aplikacion për smartphone me informacion turistik i përditësuar. Guidë turistike e Bashkisë Shkodër e përditësuar dhe e rikonceptuar në dy gjuhë. 3 harta turistike për destinacione të veçanta të territorit të Bashkisë, Kalendar i ngjarjeve kulturore I | Web site i dedikuar për turizmin i përditësuar, aplikacion për smartphone me informacion turistik. Guidë turistike e Bashkisë Shkodër e përditësuar dhe e rikonceptuar në dy gjuhë. 3 harta turistike për destinacione të veçanta të territorit të Bashkisë, Kalendar i ngjarjeve kulturore I përditësuar. të paktën 3 |

| | | |
|---|---|---|
| të itinerareve turistike në territorin e Shkodrës | përditësuar. | botime të itinerareve turistike në territorin e Shkodrës |

### 3.6.1 Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F6.O1

| Aktiviteti | Buxheti në mijë lekë |
|---|---|
| **P6.F6.O1.A1.** Krijimi i faqes web për turizmin e rajonit të Shkodrës, hostim, mirembajtje, perditesim dhe sherbime shtese per web sitin e turizmit | 80 |
| **P6.F6.O1.A2.** Konceptim dhe krijim i nje aplikacioni per smartphone qe sherben per informimin dhe orientimin e vizitoreve | 350 |
| **P6.F6.O1.A3.** Pergatitja dhe publikimi i guidës turistike të Bashkisë Shkodër.Perditesim dhe ribotim i guides turistike te Bashkise Shkodër | 350 |
| **P6.F6.O1.A4.** Publikimi i hartës turisitike së territorit të Bashkisë. Ribotim i hartave turistike te Bashkise Shkoder | 350 |
| **P6.F6.O1.A5.** Publikimi i kalendarit vjetor të aktiviteteve kulturore të Bashkisë | 120 |
| **P6.F6.O1.A6.** Prodhimi i materialeve promocionale te tilla si dosje, stilolapsa, canta, cakmake etj. | 200 |
| **P6.F6.O1.A7.** Pergatitja dhe publikimi I itinerareve turistike | 200 |

**F6.O2 Organizim dhe pjesëmarrje në panaire lokale, kombëtare dhe ndërkombetare**

**Situata e vleresuar në fund të vitit 2017:**
Organizimi periodik i një panairi turizmit.

| Situata e synuar 2018 | Situata e synuar 2019 | Situata e synuar 2020 |
|---|---|---|
| Organizimi i panairit të Artizanatit në Ditën ndërkombëtare të Artizanatit<br><br>Pjesëmarrje në dy panaire ndërkombëtare | Organizimi i panairit të Artizanatit në Ditën ndërkombëtare të Artizanatit dhe Panairit të Ofertës Turistike.<br><br>Pjesëmarrje ne dy panaire ndërkombëtare | Organizimi i panairit të Artizanatit në Ditën ndërkombëtare të Artizanatit dhe Panairit të Ofertës Turistike.<br><br>Pjesëmarrje ne dy panaire ndërkombëtare |

### 3.6.2 Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F6.O2.

| Aktiviteti | Buxheti në mijë lekë |
|---|---|
| **P6.F6.O2.A1.** Panairi i artizanatit në ditën ndërkombëtare të artizanatit | 350 |
| **P6.F6.O2.A3.** Pjesëmarrje në panaire kombetare dhe ndërkombëtare për ofertën turistike të Shkodrës | 550 |

**F6.O3 Organizimi iaktiviteteve për promovimin e ofertave dhe produkteve turistike të Bashkisë Shkodër.**

**Situata e vleresuar në fund te vitit 2017:**
Organizimi i 6 aktiviteteve social kulturore dhe sportive

| Situata e synuar 2018 | Situata e synuar 2019 | Situata e synuar 2020 |
|---|---|---|
| Organizimi i tetë aktiviteteve kulturore për promovimin e turizmit dhe të territorit. | Organizimi i tetë aktiviteteve kulturore për promovimin e turizmit dhe të territorit. | Organizimi i tetë aktiviteteve kulturore për promovimin e turizmit dhe të territorit. |

### 3.6.3 Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F6.O3

| Aktiviteti | Buxheti në mijë lekë |
|---|---|
| **P6.F6.O3.A1.** Festa e Liqenit | 300 |
| **P6.F6.O3.A2.** Dita e turizmit | 250 |
| **P6.F6.O3.A4.** Hapja e sezonit turistik Velipoje | 400 |
| **P6.F6.O3.A5.** Feste e Thethit | 400 |
| **P6.F6.O3.A6.** Dita e biçikletave | 350 |
| **P6:F6:O3:A7.** Triathlon | 350 |
| **P6:F6:O3:A8.** Mbështetje për Panairin e Ornitologjisë | 150 |
| **P6:F6:O3:A9.** Lojra Popullore Fest | 250 |

**F6.O4. Forcimi institucional nëpërmjet ngritjes së strukturave te dedikuara për përmirësimin e shërbimit ndaj vizitorit.**

**Situata e vleresuar në fund te vitit 2017:**
Në territorin adminstrativ të Bashkisë Shkodër funksionojnë tre zyra të informacionit turistik.

| Situata e synuar 2018 | Situata e synuar 2019 | Situata e synuar 2020 |
|---|---|---|
| Në territorin adminstrativ të Bashkisë Shkodër funksionojnë tre zyra të informacionit turistik | Në territorin adminstrativ të Bashkisë Shkodër funksionojnë tre zyra të informacionit turistik | Në territorin adminstrativ të Bashkisë Shkodër funksionojnë tre zyra të informacionit turistik |

### 3.6.4 Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F6.O4

| Aktiviteti | Buxheti në mijë lekë |
|---|---|
| **P6.F6.O4:A1.** Vazhdimi i aktivitetit i Zyrës së Informacionit Turistik në teritorin administrativ të qytetit Shkodër, Zyrës së Informacionit Turistik në njësinë administrative Velipojë, Zyrës së Informacionit Turistik në Theth | |

| | |
|---|---|
| **P6.F6.O4:A2.** Termoizolim dhe blerje paisjesh per mobilimin e Zyrave te informacionit turistik | 300 |

**F6.O5 Hartim i planeve dhe studimeve të zhvillimit të turizmit nga bashkëpunimi me struktura të interesuara dhe Universitetin.**

**Situata e vleresuar në fund te vitit 2017:**
Ngritja e bordit këshillimor të turizmit. Një plan studimor (i sinjalistikës turistike)

| Situata e synuar 2018 | Situata e synuar 2019 | Situata e synuar 2020 |
|---|---|---|
| Bordi këshilimor i zhvillimit të turizmit zhvillon aktivitetin e vet sipas një kalendari të caktuar takimesh. Plani i marketingut të territorit. | Bordi këshilimor i zhvillimit të turizmit zhvillon aktivitetin e vet sipas një kalendari të caktuar takimesh. | Bordi këshilimor i zhvillimit të turizmit zhvillon aktivitetin e vet sipas një kalendari të caktuar takimesh. |

### 3.6.5 Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F6.O5

| Aktiviteti | Buxheti në mijë lekë |
|---|---|
| **P6.F6.O5:A1.** Hartimi i planit te marketingut te produktit turistik te territorit te Bashkise Shkoder ne bashkepunim me Universitetin Shkodres | |
| **P6.F6.O5:A3.** Ngritja e bordit keshillimor te perhershem me perfaqesues te te gjithe aktoreve te interesuar ne zhvilimin e turizmit | |

**F6.O6 Ngritje e kapaciteteve të bizneseve që operojnë në fushën e turizmit me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimit nga ana e tyre.**

**Situata e vleresuar në fund te vitit 2017:**
Nje trainim (me gra në biznese turistike). Numri i bisneseve pjesëmarrëse 15. Numri i punonjesve te trajnuar 20.

| Situata e synuar 2018 | Situata e synuar 2019 | Situata e synuar 2020 |
|---|---|---|
| Një trainim (për guidat turistike). Numri i guidave të trajnuar 20 | Një trajnim (me bizneset e shërbimeve turistike). Numri i bizneseve pjesëmarrëse 15. Numri i punonjësve të trajnuar 20. | |

### 3.6.6 Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F6.O6

| Aktiviteti | Buxheti në mijë lekë |
|---|---|
| **P6.F6.O6:A2.** Trajnime të guidave turistike që ushtrojnë aktivitetin në territorin e Shkodrës | 200 |

**F6.O7 Permiresimi i infrastrukturës turistike dhe aksesit.**

**Situata e vleresuar në fund te vitit 2017:**
Ndërtim i një ballkoni panoramik në anën jugperëndimore të Kalasë Rozafa.

| Situata e synuar 2018 | Situata e synuar 2019 | Situata e synuar 2020 |
|---|---|---|
| Vendosje e të paktën 10 tabelave. Mirëmbajtje e 2 shtigjeve dhe e sinjalistikës përkatëse në Theth. Përmirësim i aksesit në shpellën e Gajtanit. | Vendosje e të paktën 10 tabelave informative dhe/ose orientuese për objektet e interesit. Përmirësim i aksesit në shpellën e Jubanit. | Mirëmbajtje e 3 shtigjeve dhe e sinjalistikës përkatëse në Theth. Konceptimi dhe ndërtimi i infrastrukturës përkatëse të dy shtigjeve në malin e Taraboshit. Rehabilitimi i të paktën 2 shkallareve dhe 2 plazheve. |

### 3.6.7 Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F6.O7.

| Aktiviteti | Buxheti në mijë lekë |
|---|---|
| **P6.F6.O7:A1.** Mirembajtje e shtigjeve ekzistuese për ecje në Theth | 250 |
| **P6.F6.O7.A3.** Vendosja e tabelave orientuese dhe informuese | 350 |
| **P6.F6.O7:A6.** Permiresim i aksesit se shpelles se Gajtanit nepermjet pastrimit dhe venies ne kushte sigurie te shtegut qe te con ne kete shpelle | 400 |
| **P6.F6.O7.A8.** Bashkëfinancim i projektit "Rigjenerimi i zonës së mbrojtur të liqenit të Shkodres përmes forcimit të qeverisjes lokale | 600 |

## 4. Buxhetimi i programit të Zhvillimi ekonomik lokal dhe turizmit

Për realizimin e aktiviteteve/projekteve të Zhvillimit ekonomik lokal dhe turizmit, për vitin 2018, planifikohet buxheti me vlerë totale 13,314 mijë lekë ndër të cilat 36 % Shpenzime Operative, 54 % Transferta, si dhe 10 % Investime.

Tabelë 1 Planifikimi për programin e Zhvillimit ekonomik lokal dhe turizmit

| Programi P6 | Paga + Sigurime | Shpenzime Operative | Subvensioni | Transferta | Investime | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Plani 2017** | 0 | 3,600 | 0 | 3,350 | 7,950 | **14,900** |
| **Plani 2018** | 0 | 4,850 | 0 | 7,164 | 1,300 | **13,314** |
| **Plani 2019** | 0 | 4,370 | 0 | 8,784 | 21,400 | **34,554** |
| **Plani 2020** | 0 | 5,110 | 0 | 7,326 | 2,200 | **14,636** |




**Grafiku 1 Planifikimi i shpenzimeve për zhvillimin ekonomik lokal dhe turizmin**

## 5. Projektet dhe aktivitetet e planifikuara për zhvillimi ekonomik lokal dhe turizmit

| | | |
|---|---|---|
| **Nr. 1** | **P6.F1.O1.A1.**<br>Monitorimi dhe vlerësimi i Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Shkodër. | **Llojet e programit: P6** Zhvillimi ekonomik lokal dhe turizmi.<br>**Funksioni: P6.F1.** Hartimi i planeve dhe programeve për zhvillimin ekonomik lokal. |

**a) Përshkrim i shkurtër i projektit:**

**i. Situata**

Hartimi i Planit të Përgjithshëm Vendor konsiderohet si një instrument i rëndësishëm për zhvillim, i cili përfshin identifikimin dhe shfrytëzimin kryesisht të burimeve vendore, ideve dhe aftësive për të stimuluar rritjen dhe zhvillimin ekonomik. Ky proces shoqërohet me 'monitorimin dhe vlerësimin' e tij, si mekanizëm tepër i vlefshëm për të treguar nëse burimet në dispozicion janë të mjaftueshme, janë përdorur me efektivitet dhe nëse po bëhet ajo që është planifikuar. Si rrjedhojë, Bashkia Shkodër ka përgjegjësinë e garantimit, që plani i zhvillimit ekonomik të përmbushë objektivat e deklaruara dhe me efektivitet kostoje për dy arsye kryesore, marrjen e vendimeve dhe vendosjen e përgjegjshmërisë.

**ii. Synimi i projektit**

Projekti ka për qëllim të monitorojë dhe vlerësojë Planin e Përgjithshëm Vendor, të raportojë mbi bazën e alokimit faktik të burimeve financiare dhe të matë rezultatet e arritura në raport me rezultatet e planifikuara.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

1. Hartimi i planit për analizën e të dhënave;
2. Analizimi i të dhënave për ndikimin e planit, zbatimi i aktiviteteve përkatëse, arritja e qëllimeve të tij;
3. Gjetja e rekomandimeve dhe konkluzioneve;
4. Përgatitja e raportit të monitorimit dhe vlerësimit;
5. Shpërndarja e informacionit.

**b) Rezultatet që prisni**

- Realizimi i monitorimit për çdo vit në fund të një viti fiskal i Planit të Përgjithshëm Vendor për situatën aktuale dhe zbatimin e PPV-së për identifikimin e problemit, gjetjen e zgjidhjes dhe matjen e progresit ndaj rezultateve të dhëna.
- Realizimi i vlerësimit të kryer në mes dhe në fund të përiudhës së zbatimit të i Planit të Përgjithshëm Vendor.

| **c) Aktorët e mundshëm** | **d) Kontributet e mundshme në projekt** |
|---|---|
| Bashkia Shkodër<br>Grupet e interesit | Bashkia Shkodër, Donatorë, Programe të BE-së. |

e) Shpenzimet e llogaritura

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2018** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Hartimi i planit për analizën e të dhënave. | | | | | | |
| A.2 | Analizimi i të dhënave për ndikimin e planit, zbatimin e aktiviteteve përkatëse, arritja e qëllimeve të tij. | | | | | | |
| A.3 | Gjetja e rekomandimeve dhe konkluzioneve. | | | | | | |
| A.4 | Përgatitjen e raportit të monitorimit dhe vlerësimit. | | | | | | |
| A.5 | Shpërndarja e informacionit. | | | | | | |
| | **Shuma** | | | | | | |

| | |
|---|---|
| **f) Periudha e zbatimit (kur fillon, kur përfundon)**<br>**2018**<br>**2019**<br>**2020** | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**<br>Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit<br>Institucioni likujdues:Bashkia Shkoder |

| Nr.3 | **P6.F1.O1.A3.**<br>Hartimi i plan bizneseve për menaxhimin e aseteve të Bashkisë Shkodër. | **<u>Llojet e programit</u> :P6** Zhvillimi ekonomik lokal dhe turizmi.<br>**Funksioni P6.F1** Hartimi i planeve dhe programeve për zhvillimin ekonomik lokal**.** |
|---|---|---|

**a) Përshkrim i shkurtër i projektit**

**i. Situata**

Menaxhimi i aseteve ka shumë përfitime pozitive. Institucionet që vendosin në zbatim parimet e menaxhimit të aseteve arrijnë të kenë shumë përfitime të cilat fillojnë që nga administrimi i mirë i tyre deri tek gjenerimi i të ardhurave nga ky menaxhim. Me përfundimin e studimit të fizibilitetit për menaxhimin e aseteve të Bashkisë Shkodër do të fillojë faza e hartimit të Plan Bizneseve për menaxhimin e aseteve të identifikuara në këtë studim sipas funksioneve dhe potencialeve të secilit aset duke krijuar premisat e investimeve dhe gjetjes së partneriteteve.
Menaxhimi i aseteve është një pjesë e rëndësishme e qeverisjes lokale të mirë. Praktikat e menaxhimit të aseteve janë akoma një risi për institucionet Shqiptare prandaj duhen marrë praktikat më të mira të zhvilluara në vendet e BE në hartimin e planeve të biznesit për menaxhimin e tyre. Hartimi i Plan Bizneseve për menaxhimin e aseteve luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin e qëndueshëm ekonomik të Bashkisë Shkodër. Plan Bizneset do të japin një kuptim më të qartë të riskut/pasojave të vendimeve për investimet përkatëse dhe do të jenë mjete të besueshëm për vendimmarrjen dhe planifikimin e investimeve dhe bashkëpunimeve në të ardhmen.

**ii. Synimi i projektit**

Përmirësimi i menaxhimit të aseteve të Bashkisë Shkodër me qëllim gjenerimin e të ardhurave dhe rritjen e shërbimeve.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

1. Identifikimi i aseteve të Bashkisë Shkodër dhe i orientimit zhvillimor që duhet të marrin.
2. Takime konsultative me aktorët e interesuar për zhvillimin e aseteve të Bashkisë Shkodër.
3. Takim me investitorë të ndryshëm për gjetjen e mundësive të bashkëpunimit.
4. Hartimi i Plan Bizneseve për menaxhimin e aseteve të Bashkisë Shkodër.

**b) Rezultatet që prisni**

- Nxitje e investimeve në asetet publike dhe private të Bashkisë Shkodër në shërbim të zhvillimit.
- Forcim i bashkëpunimit ndërmjet biznesit privat dhe Bashkisë Shkodër.
- Përmirësim i standardeve për menaxhimin e aseteve të bashkisë.

| c) Aktorët e mundshëm | d) Kontributet e mundshme në projekt |
|---|---|
| Bashkia Shkodër<br>Universiteti i Shkodrës<br>Dhoma e Tregtisë<br>Bizneset<br>Komuniteti | Bashkia Shkodër |

**e) Shpenzimet e llogaritura**

| Shpenzimet për çdo aktivitet 2018 | | Totali (000 lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Identifikimi i aseteve të Bashkisë Shkodër dhe i orientimit zhvillimor që duhet të marrin. | | | | | | |
| A.2 | Takime konsultative me aktorët e interesuar për zhvillimin e aseteve të Bashkisë Shkodër. | | | | | | |
| A.3 | Takim me Investitorë të ndryshëm për gjetjen e mundësive të bashkëpunimit. | | | | | | |
| | **Shuma** | **0** | | | | | |

| Shpenzimet për çdo aktivitet 2019 | | Totali (000 lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Identifikimi i aseteve të Bashkisë Shkodër dhe i orientimit zhvillimor që duhet të marrin. | | | | | | |
| A.2 | Takime konsultative me aktorët e interesuar për zhvillimin e aseteve të Bashkisë Shkodër. | | | | | | |
| A.3 | Takim me investitorë të ndryshëm për gjetjen e mundësive të bashkëpunimit. | | | | | | |
| A.4 | Hartimi i Plan Bizneseve për menaxhimin e aseteve të Bashkisë Shkodër. | | | | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **Shuma** | | | | | | |
| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2020** | | Totali (000 lek) | Nga kjo: | | | | |
| | | | Paga | Siguri me | Operat ive | Transfer ime | Kapit ale |
| A. 1 | Identifikimi i aseteve të Bashkisë Shkodër dhe i orientimit zhvillimor që duhet të marrin. | | | | | | |
| A. 2 | Takime konsultative me aktorët e interesuar për zhvillimin e aseteve të Bashkisë Shkodër. | | | | | | |
| A. 3 | Takim me Investitorë të ndryshëm për gjetjen e mundësive të bashkëpunimit. | | | | | | |
| A. 4 | Hartimi i Plan Bizneseve për menaxhimin e aseteve të Bashkisë Shkodër. | | | | | | |
| | **Shuma** | | | | | | |
| **f) Periudha e zbatimit (kur fillon, kur përfundon)**<br>**2018**<br>**2019**<br>**2020** | | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**<br>Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit<br>Institucioni likujdues:Bashkia Shkoder | | | | | |

| Nr. 4 | **P6.F1.O1.A4.** Krijimi i instrumentit financiar për forcimin e kapaciteteve të OSHC-ve nëpërmjet aplikimeve në bazë projekti për ofrimin e shërbimeve cilësore në komunitet.(ReLOad) | **Llojet e programit: P6** Zhvillimi ekonomik lokal dhe turizmi.<br>**Funksioni: P6.F1.** Hartimi i planeve dhe programeve për zhvillimin ekonomik lokal. |
|---|---|---|

**a) Përshkrim i shkurtër i projektit:**

**i. Situata**

Pjesëmarrja në Programet Europiane është projektuar për t'u mundësuar shteteve, njohjen me metodat dhe politikat e Bashkimit Europian (BE). Anëtarësimi në Bashkimin Europian (BE) konsiderohet si një sfidë, por gjithashtu edhe një mundësi për t'iu përgjigjur pritshmërive të qytetarëve për forcimin e demokracisë dhe zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Integrimi europian është prioriteti kryesor për Shqipërinë dhe një rol të rëndësishëm luan edhe qeverisja vendore. Shqipëria përfiton nga Programet Europiane dhe në këtë kuadër edhe njësitë e qeverisjes vendore kanë të drejtë të përfitojnë nga financimi i fondeve të BE-së. Shkalla e përfitimit të fondeve të BE-së në nivel vendor varet nga angazhimi i njësive vendore në këtë proces.

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e bashkëpunimit ndërkufitar dhe rajonal, Bashkia Shkodër shpreh angazhimin e saj për marrjen pjesë në Programet e BE-së me qëllim rritjen e shërbimeve publike për qytetarët me standarde europiane. Konkretisht Bashkia Shkodër është shpallur fituese në thirrjen e lançuar nga Programi Rajonal për Demokraci Lokale në Ballkanin Perëndimor (ReLOaD). Ky Program është një iniciativë rajonale tre-vjeçare e financuar me fonde të Bashkimit Europian nga Instrumentet e Asistencës së Para-Anëtarësimit (IPA) dhe zbatohet nga UNDP në gjashtë vende të Ballkanit Perëndimor. Referuar kushteve të Programit ReLOaD, Bashkia Shkodër merr përsipër përgjegjësinë e bashkëfinancimit në masën 22% të vlerës së projekti ReLOaD. Bashkëfinancimi do të programohet i ndarë në dy vite buxhetore për përiudhën e kohëzgjatjes së projektit 2018 – 2020. Bashkia Shkodër angazhohet që gjatë periudhës kohore 2018 – 2020 të organizojë tre thirrje publike, nga të cilat, dy të parat do të financohen nga shuma e alokuar e grantit (fondet e PNUD dhe 22% bashkëfinancimi i bashkisë) dhe thirrja e fundit do të financohet nga fondet e vetë bashkisë. Thirrjet do të realizohen mbi bazën e dokumentave strategjike dhe prioriteteve që Bashkia Shkodër ka. I gjithë procesi do të konsultohet me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile. Për tre thirrjet e organizuara do të zbatohet Metodologjia LOD.

**ii. Synimi i projektit**

Qëllimi është zbatimi i qasjes në bazë projekti, në mënyrë që bashkitë të realizojnë objektivat e tyre zhvillimore, në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

Bashkia Shkodër angazhohet që gjatë periudhës kohore 2018 – 2020 të organizojë tre thirrje publike, sipas metodologjisë LOD, nga të cilat:

- ✓ Dy të parat do të financohen nga shuma e alokuar e grantit (fondet e PNUD dhe 22% bashkëfinancimi i bashkisë);
- ✓ Thirrja e fundit do të financohet nga fondet e vetë bashkisë.

**b) Rezultatet që prisni**

- Ngritje e kapaciteteve institucionale;
- Përmirësim i shërbimeve me standarde europiane;
- Përfshirje e shoqërisë civile në vendimarrje;
- Rritje e transparencës me publikun.

| **c) Aktorët e mundshëm (grupet që lidhen me projektin dhe që ndikohen)** | **d) Kontributet e mundshme në projekt (kush do të kontribuojë për këtë projekt, financiarisht, etj.)** |
|---|---|
| Bashkia Shkodër<br>UNDP Albania<br>Delegacioni i Bashkimit Europian | Programi Rajonal për Demokraci Lokale në Ballkanin Perëndimor (ReLOaD)<br>Bashkia Shkodër<br>Programet e BE-së |

**e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm (pika iii)**

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2018** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurim e | Oper ative | Transf erime | Kapitale |
| A. 1 | Transfertë e vlerës së bashkëfinancimit e programuar në buxhetin e Bashkisë Shkodër për projektin ReLOad | | | | | | |
| | **Shuma** | **1,474** | | | | **1,474** | |

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2019** | | Totali (mije lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Siguri me | Operativ e | Transf erime | Kapitale |
| A. 1 | Transfertë e vlerës së bashkëfinancimit e programuar në buxhetin e Bashkisë Shkodër për projektin ReLOad | | | | | | |
| | **Shuma** | **1,177** | | | | **1,177** | |

| Shpenzimet për çdo aktivitet 2020 | | Totali (mije lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Siguri me | Operativ e | Transf erime | Kapitale |
| A. 1 | Transfertë e vlerës së bashkëfinancimit e programuar në buxhetin e Bashkisë Shkodër për projektin ReLOad. | | | | | | |
| | **Shuma** | **536** | | | | **536** | |

| | |
|---|---|
| **f) Përiudha e zbatimit (kur fillon, kur përfundon)**<br>**2018**<br>**2019**<br>**2020** | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**<br>Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit<br>Drejtoria e Turizmit<br>Drejtoria e Shërbimeve Publike, Ndjekjes së Investimeve të Infrastrukturës<br>Drejtoria e Shërbimeve Socialeve dhe Strehimit<br>Drejtoria e Mjedisit, Pyjeve dhe Menaxhimit të Ujrave.<br>Institucioni likujdues:Bashkia Shkoder |

| | | |
|---|---|---|
| **Nr. 5** | **P6.F1.O1.A5.** Pjesmarrje në programet dhe projektet e financuara nga Bashkimi Europian dhe Organizata të tjera ndërkombëtare. | **Llojet e programit: P6** Zhvillimi ekonomik lokal dhe turizmi.<br>**Funksioni: P6.F1.** Hartimi i planeve dhe programeve për zhvillimin ekonomik lokal. |

**a) Përshkrim i shkurtër i projektit:**

**i. Situata**

Procesi i integrimit evropian është sfida dhe prioriteti kryesor për Shqipërinë, ku pa dyshim një rol të rëndësishëm në këtë proces luan edhe qeverisja vendore. Mjetet me të cilin BE mbështet Shqipërinë në rrugën e saj drejt anëtarësimit janë programet e BE-së. Në këtë kuadër njësitë e qeverisjes vendore kanë të drejtë të përfitojnë nga financimi i fondeve të BE-së. Shkalla e përfitimit të fondeve të BE-së në nivel vendor varet nga angazhimi i njësive vendore në këtë proces. Prandaj është me shumë rëndësi që qeverisja vendore të fokusojë prioritetet e saj edhe në drejtim të forcimit të bashkëpunimit rajonal dhe ndër-rajonal duke aplikuar në programe të ndryshme të BE-së.
Duke marrë në konsideratë rëndësinë e bashkëpunimit ndërkufitar dhe rajonal, Bashkia Shkodër shpreh angazhimin e saj për marrjen pjesë në Programet e BE-së me qellim rritjen e shërbimeve publike për qytetarët me standarde të përafruara europiane. Konkretisht Bashkia Shkodër është aplikuese në disa nga programet e financuara nga BE-së dhe një ndër specifikat e thirrjeve për projekte është edhe bashkëfinancimi. Kështu për projektet e shpallura fituese nga Bashkimi Europian, Bashkia Shkodër merr përsipër bashkëfinancimin e projekteve fituese sipas specifikave të programeve të BE-së. Në këtë kuadër lind e nevojshme parashikimi i një fondi për bashkëfinancim në zërat e buxhetit vjetor dhe afatmesëm.

**ii. Synimi i projektit**

Të parashikojë fondin për bashkëfinancimet në kuadër të bashkëpunimeve në Programet e Bashkimit Europian për përiudhën 2018 – 2020.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

Bashkia Shkodër do të bashkëfinancojë me mjete financiare projektet në të cilat është shpallur fituese nga BE, sipas marrëveshjeve financiare të nënshkuara nga Bashkia Shkodër në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**b) Rezultatet që prisni**

- Ngritje e kapaciteteve institucionale;
- Përmirësim i shërbimeve me standarde europiane;
- Përfshirje e shoqërisë civile në vendimarrje;
- Rritje e transparencës me publikun.

| **c) Aktorët e mundshëm (grupet që lidhen me projektin dhe që ndikohen)** | **d) Kontributet e mundshme në projekt (kush do të kontribuojë për këtë projekt, financiarisht, etj.)** |
|---|---|
| Bashkia Shkodër<br>Delegacioni i Bashkimit Europian | Bashkia Shkodër<br>Programet e BE-së |

**e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm (pika iii)**

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2019** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Siguri me | Operati ve | Transfer ime | Kapitale |
| A. 1 | Transfertë e vlerës së bashkëfinancimit e programuar në buxhetin e Bashkisë Shkodër për projekte të tjera të BE-së. | | | | | | |
| | **Shuma** | **967** | | | | **967** | |

| | |
|---|---|
| **f) Përiudha e zbatimit (kur fillon, kur përfundon)**<br>**2019** | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**<br>Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit<br>Institucioni likujdues:Bashkia Shkoder |

| Nr.12 | **Projekti: P6.F3.O1.A1**<br>Organizimi i panairit të punës dhe bizneseve në Bashkinë Shkodër. | **Llojet e programit :P6** Zhvillimi ekonomik lokal dhe turizmi.<br>**Funksioni P6.F3** Mbështetje për zhvillimin e biznesit të vogël nëpërmjet veprimtarive nxitëse, të tilla si panaire e reklama në vende publike. |
|---|---|---|

**a) Përshkrim i shkurter i projektit**

**i. Situata**

Rajoni i Shkodrës, është i prekur nga një numër i lartë i të papunëve. Në Universitetin e Shkodrës si dhe në shkollat profesionale çdo vit diplomohet një numër i konsiderueshëm studentësh, të cilët kanë vështirësi të integrohen në tregun e punës. Nga ana tjetër në Bashkinë e Shkodrës operojnë një numër relativisht i mirë i aktviteteve ekonomike të sektorëve të ndryshëm, të cilët gjithashtu herë pas here kanë vështirësi në gjetjen e punonjësve e sidomos të atyre të kualifikuar. Kjo gjë ndodh nga mungesa e informacionit si për vendet vakante të punës, por gjithashtu edhe për nevojën që kanë bizneset për të punësuar punonjës të kualifikuar. Për këtë arsye, Bashkia Shkodër, ashtu si vitin e kaluar, ka parashikuar organizimin e panairit të përvitshëm të punës me pjesëmarrjen e aktorëve të rëndësishëm në këtë proces ku mund të përmendim Universitetin e Shkodrës, shkollat e mesme profesionale dhe bizneset që kanë aktivitetin e tyre tregtar në Shkodër dhe më gjërë. Në këtë panair, bizneset do të kenë mundësi të promovojnë produktet e tyre, si një mundësi për tu njohur në tregun rajonal e më gjërë si dhe te njihen me potencialin e fuqisë punëtore të kualifikuar.

**ii. Synimi i projektit**

Ky projekt synon shkëmbimin e informacionit për mundësitë e tregut të punës si për punëkërkuesit ashtu edhe për punëdhënësit. Si dhe shkëmbimin e informacionit mes bizneseve dhe krijimin e mundësisë për promovimin e produkteve të tyre.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

1. Përgatitja e programit të panairit.
2. Përgatitja e materialeve promocionale si postera, banera, ftesa etj.
3. Përgatitja e sheshit dhe instalimi i logjistikës për zhvillimin e panairit.
4. Njoftimet në media elektrtonike për zhvillimin e aktivitetit.

**b) Rezultatet që prisni**

Njohja dhe prezantimi në rajon e më gjerë të bizneseve prodhuese që operojnë në Bashkinë Shkodër si dhe nxitja e punësimit të studendeve.

| **c) Aktorët e mundshëm** | **d) Kontributet e mundshme në projekt** |
|---|---|
| Bashkia Shkodër<br>Dhoma e Tregtisë<br>Universiteti Shkodër<br>Shkollat e mesme profesionale<br>Zyra Rajonale e Punësimit Shkodër | Bashkia Shkodër |

**e) Shpenzimet e llogaritura ( për çdo aktivitet të mësipërm (pika iii)**

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2018** | | Totali (000 lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Përgatitja e materialeve promocionale si postera, banera, ftesa etj. | | | | | | |
| A.2 | Instalimi i logjistikës për zhvillimin e panairit. | | | | | | |
| **Shuma** | | **300** | | | **300** | | |

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2019** | | Totali (000 lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Përgatitja e materialeve promocionale si postera, banera , ftesa etj. | | | | | | |
| A.2 | Instalimi i logjistikës për zhvillimin e panairit. | | | | | | |
| **Shuma** | | **300** | | | **300** | | |

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2020** | | Totali (000 lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Përgatitja e materialeve promocionale si postera, banera , ftesa etj. | | | | | | |
| A.2 | Instalimi i logjistikës për zhvillimin e panairit. | | | | | | |
| **Shuma** | | **300** | | | **300** | | |

| **f) Periudha e zbatimit**<br>**2018**<br>**2019**<br>**2020** | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**<br>Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit<br>Institucioni likujdues:Bashkia Shkoder |
|---|---|

| Nr. 13 | **P6.F3.O1.A2**<br>Panairi i produkteve agropërpunuese sipas njësive administrative | **Llojet e programit: P6** Zhvillimi ekonomik lokal dhe turizmit.<br>**Funksioni:P6. F3.** Mbështetjen për zhvillimin e biznesit të vogël nëpërmjet veprimtarive nxitëse, të tilla si panaire e reklama në vende publike. |
|---|---|---|

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:**

**i. Situata**

Bashkia Shkodër për shkak të pozicionimit gjeografik dhe resurseve natyrore që disponon ka potenciale të madhe për zhvillimin ekonomik. Baza ekonomike është blektoria, sidomos në zonën malore të saj, ndërsa në zonën fushore përparësi ka bujqësia, kryesisht drithërat e bukës. Përveç tyre, produkte të tjera tipike të zonës janë të lidhura me vreshtarinë, ullishtat dhe frutat/perimet. Po ashtu, afërsia me liqenin ka nxitur edhe peshkimin. Kjo pasuri mund të hulumtohet nga aspekte të ndryshme, sepse paraqet një fushë të gjërë, ku pa dyshim një vend të rëndësishëm zënë produktet agropërpunuese. Sektori i agropërpunimit është një ndër sektorët e ekonomisë e cila gërsheton potencialet e burimeve natyrore, pozitën gjeografike, traditën e rajonit por gjithashtu edhe interesin në rritje të aktorëve dhe partnerëve të rëndësishëm për rajonin. Si e tillë vërehet praninë e bizneseve agro përpunuese të lidhura drejtpërdrejt me tregtinë. Por përtej mundësive që vendi ofron ky sektor ndeshet me disa problematika që kanë të bëjnë kryesisht me investimet për modernizimin e teknologjisë, standardizimin, konkurrueshmërinë, nxitjen e promovimit të markave rajonale, kapacitetet menaxhuese etj. Në këtë kuadër me qellim zhvillimin e biznesit të vogël nëpërmjet veprimtarive nxitëse do të organizohet panairi i produkteve agropërpunuese. Në këtë panair do të prezantohen të gjitha njësitë administrative të Bashkisë Shkodër me produktet vendase, me pasuritë e tyre kulturore dhe ushqimin tradicional**,** secila do të ndërtojë në panair stendën e saj. Ky manifestim do të jetë i tipit të hapur për pjesëmarresit. Kjo traditë do të vazhdojë edhe në vitet e ardhshme me më shumë prodhues e më shumë prodhime vëndase.

**ii. Synimi i projektit**

Ky projekt ka për qëllim promovimin e produkteve të sektorit agropërpunuese sipas njësive administrative të Bashkisë Shkodër.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

1. Përgatitja e programit të panairit të produkteve agropërpunuese.
2. Përgatitja e materialeve promocionale si postera , banera , ftesa etj.
3. Përgatitja e sheshit dhe instalimi i logjistikes për zhvillimin e panairit.
4. Njoftimet në media për zhvillimin e aktivitetit.

**b) Rezultatet që prisni**

Pjesëmarrje e një numri të gjërë prodhuesish të produkteve vëndase, përfaqësimi i 11 njësive administrative në panair me produktetet që i karaktërizojnë.

| **c) Aktorët e mundshëm** | **d) Kontributet e mundshme në projekt** |
|---|---|
| Bashkia Shkodër<br>Dhoma e Tregetisë<br>Bisnese Prodhuesish<br>Shoqata që operojnë në këtë fushë | Bashkia Shkodër<br>Donatorë |

**e) Shpenzimet e llogaritura**

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2018** | | Totali (mije lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operativ e | Transferi me | Kapit ale |
| A.1 | Përgatitja e materialeve promocionale si postera , banera , ftesa etj. | | | | | | |
| A.2 | Përgatitja e sheshit dhe instalimi i logjistikes për zhvillimin e panairit | | | | | | |
| | **Shuma** | **700** | | | **700** | | |
| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2019** | | Totali (mije lekë) | Nga kjo: | | | | |
| | | | Paga | Sigurime | Operativ e | Transferi me | Kapit ale |
| A.1 | Përgatitja e materialeve promocionale si postera , banera , ftesa etj. | | | | | | |
| A.2 | Përgatitja e sheshit dhe instalimi i logjistikës për zhvillimin e panairit | | | | | | |
| | **Shuma** | **700** | | | **700** | | |
| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2020** | | Totali( mije lekë) | Nga kjo: | | | | |
| | | | Paga | Sigurime | Operativ e | Transferi me | Kapit ale |
| A.1 | Përgatitja e materialeve promocionale si postera, banëra , ftesa etj. | | | | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| A.2 | Përgatitja e sheshit dhe instalimi i logjistikes për zhvillimin e panairit | | | | | | |
| | **Shuma** | **700** | | | **700** | | |

| | |
|---|---|
| **f) Përiudha e zbatimit**<br>2018-2020 | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**<br>Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit<br>Drejtoria e Bujqësisë pranë Bashkisë Shkodër<br>Institucioni likujdues:Bashkia Shkoder |

| Nr. 14 | **P6.F3.O1.A3**<br>Panairi i promovimit të vlerave artistike – kulturore dhe i produkteve të territorit (për Njësitë Administrative) | **Llojet e programit: P6** Zhvillimi ekonomik lokal dhe turizmi.<br>**Funksioni: P6.F3.** Mbështetja për zhvillimin e biznesit të vogël nëpërmjet veprimtarive nxitëse, të tilla si panaire e reklama në vende publike. |
|---|---|---|

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:**

**i. Situata**

Territori i ri i Bashkisë Shkodër, si nga morfologjia e territorit dhe burimet natyrore ashtu dhe nga mënyra e zhvillimit është një territor shumë i larmishëm dhe dinamik. Si i tillë përveç potencialeve të shumta natyrore, paraqet edhe potenciale të trashëgimisë materiale dhe shpirtërore të zonës. Qyteti, rrethinat dhe malësitë e Bashkisë Shkodër janë dalluar për prodhimet artizanale si punimet prej thupre, bakri, argjendi e druri, qëndismat, qilimat, etj. Gjithashtu e gjithë zona është karakterizuar nga veshje tradicionale funksionale për çdo ceremoni dhe për jetën e përditshme. Të tilla janë, kostumet e qytetit (të komunitetit musliman, atij katolik dhe ortodoks), të zonave rurale (të Postribës, të Zadrimës, të Bregut të Bunës etj), të Malësive (Shale, Shosh, Pult). Një larmi tejet të madhe edhe në shkallë vendi paraqet bashkia për sa i përket pasqyrimit të shpirtit njerëzorë përmes këngës, vlen për tu theksuar ahengu shkodran, këndimi me lahutë i rapsodive të vjetra kreshnike, këngët e shoqëruara me çifteli, vallëzimi në çift ose në grup. Po ashtu Bashkia e re është dalluar për një numër të madh prodhimesh tradicionale me bazë burimet natyrore të saj.
Në këtë kuadër është parashikuar organizimi i panairit në njësitë administrative. Ato do të prezantohen me pasuritë e tyre kulturore, veshje, grupe folklorike dhe ushqim tradicional. Ky panair vlerësohet si një mundësi shumë e mirë për të promovuar vlerat kulturore, pasuritë natyrore që vendi ka por edhe produktet e sektorit të agrobiznesit.
Këto panaire do të jenë të tipit të hapur për pjesëmarrësit. Kjo traditë do të vazhdojë edhe në vitet e ardhshme me më shumë aktivitete kulturore e më shumë prodhime vendase. Ky aktivitet konsiston në dy drejtime: organizimin e aktivitetit artistik të vlerave kulturore të zonave (promovimin e veshjeve tradicionale, këngë dhe valle të zonave) si dhe organizimin e panairit të produkteve të territorit (për njësitë administrative).
Në vitin 2018 është parashikuar të zhvillohet nga një panair për secilën nga 10 njësitë administrative, gjithashtu edhe në vitet 2019 - 2020 do të zhvillohet nga një panair për secilën njësi administrative, duke krijuar kështu një traditë të përvitshme në promovimin e territorit të njësive administrative.
Aktiviteti i promovimit të vlerave artistike dhe kulturore të zonave do të përzgjidhet nga Këshilli Artistik Kulturor i Bashkisë Shkodër.

**ii. Synimi i projektit**

Ky projekt ka për qëllim promovimin e vlerave tradicionale të trashëgimise kulturore dhe produkteve vendase të njësive administrative të Bashkisë Shkodër.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

1. Aktivitet artistik i vlerave kulturore të zonave.
2. Përgatitje e panairit të produkteve agro-përpunuese të zonave.
    a. Përgatitja e sheshit dhe instalimi i logjistikës për zhvillimin e panairit;
    b. Përgatitja e materialeve promocionale si postera, banera , ftesa etj.
3. Njoftimet në media për zhvillimin e aktivitetit.

**b) Rezultatet që prisni**

Realizimi i panairit në 10 njësitë administrative, me pjesmarrjen e një numri të gjerë prodhuesish të produkteve vendase.
Përfaqësim i njësive administrative në panair me vlerat dhe produktet që i karakterizojnë.
Promovimi i territorit.

| **c) Aktorët e mundshëm (grupet që lidhen me projektin dhe që ndikohen)** | **d) Kontributet e mundshme në projekt (kush do të kontribuojë për këtë projekt, financiarisht, etj.)** |
|---|---|
| Bashkia Shkodër<br>Dhoma e Tregtisë<br>Biznese Prodhuesish<br>Shoqata që operojnë në këtë fushë<br>Banorët e Nj. Administrative | Bashkia Shkodër<br>Donatorë |

**e) Shpenzimet e llogaritura ( për çdo aktivitet të mësipërm (pika iii)**

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2018** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Aktivitet artistik i vlerave kulturore të zonave. | | | | | | |
| A.2 | Përgatitje e panairit të produkteve agro-përpunuese të zonave. | | | | | | |
| A.2.1 | Përgatitja e sheshit dhe instalimi i logjistikës për zhvillimin e panairit. | | | | | | |
| A.2.2 | Përgatitja e materialeve promocionale si postera, banera, ftesa etj | | | | | | |

| | Shuma | 1,440 | | | | 1,440 | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2019** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Aktivitet artistik i vlerave kulturore të zonave. | | | | | | |
| A.2 | Përgatitje e panairit të produkteve agro-përpunuese të zonave. | | | | | | |
| A.2.1 | Përgatitja e sheshit dhe instalimi i logjistikës për zhvillimin e panairit. | | | | | | |
| A.2.2 | Përgatitja e materialeve promocionale si postera, banera, ftesa etj. | | | | | | |
| | **Shuma** | **1,440** | | | | **1,440** | |
| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2020** | | Totali (mije lekë) | Nga kjo: | | | | |
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Aktivitet artistik i vlerave kulturore të zonave. | | | | | | |
| A.2 | Përgatitje e panairit të produkteve agro-përpunuese të zonave. | | | | | | |
| A.2.1 | Përgatitja e sheshit dhe instalimi i logjistikës për zhvillimin e panairit. | | | | | | |
| A.2.2 | Përgatitja e materialeve promocionale si postera, banera , ftesa etj. | | | | | | |
| | **Shuma** | **1,440** | | | | **1,440** | |

| | |
|---|---|
| **f) Periudha e zbatimit (kur fillon, kur përfundon)**<br>**2018**<br>**2019**<br>**2020** | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**<br>Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit<br>Drejtoria e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sporteve<br>Institucioni likujdues:Bashkia Shkoder |

| | | |
|---|---|---|
| **Nr.15** | **Projekti: P6.F4.O1.A1.**<br>Ribotim i profilit të Bashkisë | **Llojet e programit : P6:** Zhvillimi ekonomik lokal dhe turizmi.<br>**Funksioni P6.F4** : Publikim i broshurave informative, krijimit të portaleve me profil ekonomik. |

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit**

i. Situata (Shpjego problemin, aspektet negative, të dhëna për zonën)

Profili i bashkisë është një dokument informativ, në të cilin në mënyrë të përmbledhur jepen të dhëna statistikore dhe informacion përshkrimor në lidhje me zonën dhe komunitetin e saj.
Hartimi i këtij profili do të përfshijë të dhëna kryesore gjeografike, historike, demografike dhe social ekonomike. Është një fotografim, një prezantim i përmbledhur i të gjithë territorit i cili prezanton potencialet dhe tendencat e zhvillimit të të gjithë zonës.
Qyteti dhe disa ish Komuna të Shkodrës kanë patur të botuara profilet e territoreve administrative të tyre. Me krijimin e Bashkisë Shkodër të përbërë nga 11 njësitë administrative lind nevoja për hartimin dhe botimin e një profili të ri ku janë të përfshira dhe të integruara të gjitha informacionet për territorin administrativ të bashkisë së re. Ky ribotim është parashikuar në gjuhën angleze.

**ii. Synimi i projektit ( me një fjali çfarë do të zgjidhni për atë që është problemi kryesor, përfitimi i grupit të synuar)**

Hartimi i materialeve promocionale për zhvillimin ekonomik të Bashkisë.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit (Veprimet që do të ndërmerrni për të prodhuar rezultate)**

1. Përditësim i bazës së të dhënave për hartimin e profilit të Bashkisë;
2. Përkthimi në gjuhën angleze i profilit të Bashkisë;
3. Përditësimi i informacionit fotografik sipas tematikave të përcaktuara për ilustrim;
4. Dizenjimi dhe strukturimi i materialit të broshurës së profilit;
5. Botimi i profilit.

**b) Rezultatet që prisni ( shërbimet apo produktet që u dorëzoni përfituesve të synuar)**

Ribotimi i profilit të Bashkisë Shkodër në gjuhën angleze.

| **c) Aktorët e mundshëm (grupet që lidhen me projektin dhe që ndikohen)** | **d) Kontributet e mundshme ne projekt (kush do te kontribuoje per kete projekt, financiarisht etj.)** |
|---|---|
| Bashkia Shkodër | Bashkia Shkodër |

**e) Shpenzimet e llogaritura ( për çdo aktivitet të mësipërm (pika iii)**

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2018** | | Total i (000 lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Siguri me | Operat ive | Transferi me | Kapit ale |
| A.1 | Përditësim i bazës së të dhënave për hartimin e profilit të Bashkisë. | | | | | | |
| A.2 | Përkthimi në gjuhën angleze i profilit të Bashkisë. | | | | | | |
| A.3 | Përditësimi i informacionit fotografik sipas tematikave të përcaktuara për ilustrim. | | | | | | |
| A.4 | Dizenjimi dhe strukturimi i materialit të profilit | | | | | | |
| A.5 | Printimi i profilit | | | | | | |
| | **TOTAL** | **400** | | | **400** | | |

| **f) Periudha e zbatimit (kur fillon, kur përfundon)**<br>**2018** | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**<br>Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit |
|---|---|

| Nr .16 | **Projekti : P6.F4.O1.A2**<br>Ristrukturimi dhe pasurimi i faqes web të Bashkisë | **<u>Llojet e programit</u>: P6**. Zhvillimi ekonomik lokal dhe turizmi.<br>**Funksioni P6.F4:** Publikim i broshurave informative dhe krijimit të portaleve me profil ekonomik. |
|---|---|---|

**a) Përshkrim i shkurtër i projektit**

**i. Situata ( Shpjego problemin, aspektet negative, të dhëna për zonën)**

Bashkia Shkodër, në kuadër të programeve dhe projekteve, në vite, ka hartuar materiale të ndryshme promocionale për të promovuar shërbime të ndryshme të ofruara ndaj komunitetit në të gjitha fushat. Që në vitin 2003, Bashkia Shkodër nëpërmjet faqes së saj të internetit ofron informacione të ndryshme për sherbime ndaj qytetarëve, bizneseve si dhe informacione të ndryshme informative statistikore dhe social kulturore. Kjo faqe web e Bashkisë megjithëse ka evoluar duke u përmiresuar nga viti në vit në lidhje me strukturën e saj dhe informacionin që ofron, për sa i përket sektorit të biznesit është e nevojshme dhe e domosdoshme ristrukturimi i saj në lidhje me ofrimin e informacionit dhe shërbimeve ndaj të bërit biznes në Shkodër.

**ii. Synimi i projektit ( me një fjali çfarë do të zgjidhni për atë që është problemi kryesor, përfitimi i grupit të synuar)**

Përmirësimi i dokumentave dhe instrumentava promovues të zhvillimit ekonomik lokal digjital.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit ( Veprimet që do të ndërmerrni për të prodhuar rezultate)**

1. Përgatitja e strukturës së faqes për biznesin;
2. Përgatitja e përmbajtjes së faqes sipas strukturës;
3. Procesi i dizenjimit dhe programimit të faqes.

**b) Rezultatet që prisni ( shërbimet apo produktet që u dorezoni përfituesve të synuar)**

Faqja Web e internetit të Bashkisë Shkodër ofron informacion të plotë për shërbimet ndaj të bërit biznes në Shkodër.

| **c) Aktorët e mundshëm (grupet që lidhen me projektin dhe që ndikohen)** | **d) Kontributet e mundshme në projekt (kush do të kontribuojë për këtë projekt, financiarisht etj.)** |
|---|---|
| Bashkia Shkodër | Bashkia Shkodër |

**e) Shpenzimet e llogaritura ( për çdo aktivitet të mësipërm (pika iii)**

| **Shpenzimet për çdo aktivitet** | | Totali (000 lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferta | Kapitale |
| A.1 | Përgatitja e strukturës së faqes web. | | | | | | |
| A.2 | Përgatitja e përmbajtjes së faqes sipas strukturës. | | | | | | |
| | **TOTAL** | **0** | | | **0** | | |

| **f) Periudha e zbatimit (kur fillon, kur përfundon)**<br>**2018**<br>**2019**<br>**2020** | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**<br>Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit<br>Institucioni likujdues:Bashkia Shkoder |
|---|---|

<table>
<tr><td>Nr .17</td><td colspan="3">Projekti : P6.F4.O1.A3<br>Ribotim i broshurës informative për tërheqjen e investimeve vendase dhe të huaja në Bashkinë Shkodër.</td><td colspan="6"><u>Llojet e programit</u>: P6. Zhvillimi ekonomik lokal dhe turizmi.<br>Funksioni: P6.F4: Publikim i broshurave informative dhe krijimit të portaleve me profil ekonomik.</td></tr>
<tr><td colspan="10">a) Përshkrim i shkurtër i projektit</td></tr>
<tr><td colspan="10">i. Situata ( Shpjego problemin, aspektet negative, të dhëna për zonën)</td></tr>
<tr><td colspan="10">Gjatë viteve, në funksion të zhvillimit lokal janë hartuar një sërë materialesh si strategji, plane dhe informacione të ndryshme të botuara në formë fletepalosje dhe broshurash për promovimin e territorit në funksion të zhvillimit ekonomik. Shumë prej këtyre materialeve promovuese janë tashmë të tejkaluara në lidhje me ndryshimet e shumta për sa i përket kuadrit ligjor në lidhje me të bërit biznes. Botimi i broshurës informative për tërheqjen e investimeve është i rëndësishëm për promovimin e të gjithë territorit të Bashkisë Shkodër. Kjo broshurë do të përmbajë informacion të përgjithshëm për territorin, kuadrin ligjorë pë të bërë biznes në Shkodër, rregullat e tregut të punës, sistemin e taksave dhe tarifave kombëtare dhe lokale, etj.<br>Kjo broshure do të përmbaje informacion dhe do të promovojë të gjithë territorin administrativ të Bashkisë së re të Shkodrës .</td></tr>
<tr><td colspan="10">ii. Synimi i projektit ( me nje fjali çfarë do të zgjidhni për atë që është problemi kryesor, përfitimi i grupit të synuar)</td></tr>
<tr><td colspan="10">Promovimi i investimeve vendase dhe të huaja për zhvillimin ekonomik të Shkodrës.</td></tr>
<tr><td colspan="10">iii. Aktivitetet kryesore të projektit ( Veprimet që do të ndërmerrni për të prodhuar rezultate)</td></tr>
<tr><td colspan="10">1. Azhornimi i informacionit të broshurës.<br>2. Ribotimi i broshurës informative.</td></tr>
<tr><td colspan="10">b) Rezultatet që prisni ( shërbimet apo produktet që u dorëzoni përfituesve të synuar)</td></tr>
<tr><td colspan="10">Ribotimi i Broshurës Informative.</td></tr>
<tr><td colspan="4">c) Aktorët e mundshëm (grupet që lidhen me projektin dhe që ndikohen)</td><td colspan="6">d) Kontributet e mundshme në projekt (kush do të kontriboje për këtë projekt, financiarisht etj.)</td></tr>
<tr><td colspan="4">Bashkia Shkodër</td><td colspan="6">Bashkia Shkodër</td></tr>
<tr><td colspan="10">e) Shpenzimet e llogaritura ( për çdo aktivitet të mësipërm (pika iii)</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">Shpenzimet per çdo aktivitet 2018</td><td rowspan="2">Totali (000 lekë)</td><td colspan="6">Nga kjo:</td></tr>
<tr><td>Paga</td><td>Siguri me</td><td>Operati ve</td><td>Transfer ta</td><td colspan="2">Kapital e</td></tr>
<tr><td>A.1</td><td colspan="2">Ribotimi i broshures informative</td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td colspan="2"></td></tr>
<tr><td></td><td colspan="2">TOTAL</td><td>300</td><td></td><td></td><td>300</td><td></td><td colspan="2"></td></tr>
<tr><td colspan="3">f) Periudha e zbatimit (kur fillon, kur përfundon)<br>2018</td><td colspan="7">g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:<br>Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit<br>Institucioni likujdues:Bashkia Shkoder</td></tr>
</table>

| | | |
|---|---|---|
| **Nr.21** | **Projekti: P6.F5.O1.A1**<br>Bashkëpunimi me Zonën e Përmirësimit të Biznesit BID Shkodër. | **<u>Llojet e programit</u> :P6** Zhvillimi ekonomik lokal dhe turizmi.<br>**Funksioni P6.F5.** Dhënia e granteve dhe ndihmave financiare për mbështetjen e aktiviteteve të biznesit të vogël dhe të mesëm, sipas mënyrës së përcaktuar në legjislacionin në fuqi. |

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit**

**i. Situata**

Bashkia Shkodër në bashkëpunim me AADF (Fondacioni i Zhvillimit Shqiptaro–Amerikan) vazhdon në mënyrë të suksesshme projektin "BID Shkodra" përgjatë rrugëve "13 Dhjetori", "28 Nëntori" dhe "Kolë Idromeno". Në zbatimin e programit të bashkëpunimit me qëllim zhvillimin dhe përmirësimin e klimës së biznesit në zonë është rinovuar marrëveshja për vitin 2017 dhe në kuadër të saj, Shoqata BID ka ofruar shërbime publike shtesë, ka zhvilluar një sërë aktivitetesh kulturore, argëtuese, disa prej të cilave edhe në bashkëpunim me Bashkinë Shkodër. Ka ofruar konsulencë profesionale për bizneset e zonës me qëllim zhvillimin e qëndrueshëm dhe përmirësimin e klimës së biznesit në këtë zonë. Në Rr. "Kolë Idromeno" si rezultat i bashkëpunimit me Shoqatën BID Shkodër, nga një pjesë e mirë e bizneseve që ushtrojnë aktivitetin në këtë zonë është aplikuar koncepti "Dehors" për zënien e hapësirës publike, i miratuar në "Rregulloren për shfrytëzimin e hapësirave publike". Nga ana tjetër, është përmirësuar ndjeshëm cilësia e shërbimeve të ofruara nga bizneset në këtë zonë. Në këtë kuadër vazhdimi i bashkëpunimit me shoqatën BID Shkodra shërben për zhvillimin e mëtejshëm ekonomik të kësaj zone.

**ii. Synimi i projektit**

Qëllimi kryesor i bashkëpunimit është që të sigurojë një zonë më të pastër, më të sigurtë dhe më tërheqëse duke synuar sigurimin e burimeve të nevojshme për financimin e programeve dhe shërbimeve publike shtesë për t'iu përshtatur nevojave të biznesit duke krijuar një zonë biznesi që ka aftësi të konkurrojë përmes organizimit të ngjarjeve kulturore, argëtuese, sensibilizuese me qëllim tërheqjen e kalimtarëve të rregullt por edhe atyre potencial.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

Bashkia Shkodër do të mbështesë me mjete financiare nëpërmjet transferimit të të ardhurave nga tarifat, që mblidhen nga Bashkia Shkodër, nga bizneset anëtare të shoqatës sipas marrëveshjes së bashkëpunimit të miratuar me VKB, nr. 13, datë 12.03.2012.

**b) Rezultatet që prisni**

Forcimi dhe zhvillimi i bizneseve egzistuese, krijimi i bizneseve të reja si dhe rritja e cilësisë së shërbimit për vizitorin, që ndodhen përgjatë rrugës "13 Dhjetori", "28 Nëntori" dhe "Kolë Idromeno".

| **c) Aktorët e mundshëm** | **d) Kontributet e mundshme në projekt** |
|---|---|
| Bashkia Shkodër<br>AADF<br>BID Shkodër | Bashkia Shkodër |

**e) Shpenzimet e llogaritura**

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2018** | | Totali (000 lek) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Transferimi i të ardhurave nga tarifat që mblidhen nga Bashkia Shkodër, nga bizneset anëtare të shoqatës, të përcaktuara sipas listës së aprovuar. | | | | | 1,600 | |
| **Shuma** | | **1,600** | | | | **1,600** | |

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2019** | | Totali (000 lek) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Transferimi i të ardhurave nga tarifat që mblidhen nga Bashkia Shkodër, nga bizneset anëtare të shoqatës, të përcaktuara sipas listës së aprovuar. | **1,600** | | | | 1,600 | |
| **Shuma** | | **1,600** | | | | **1,600** | |

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2020** | | Totali (000 lek) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Transferimi i të ardhurave nga tarifat që mblidhen nga Bashkia Shkodër, nga bizneset anëtare të shoqatës, të përcaktuara sipas listës së aprovuar. | **1,600** | | | | 1,600 | |
| **Shuma** | | **1,600** | | | | **1,600** | |

| **f) Periudha e zbatimit (kur fillon, kur përfundon)**<br>**2018-2020** | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**<br>Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit<br>Institucioni likujdues:Bashkia Shkoder |
|---|---|

| Nr.22 | **Projekti: P6.F5.O1.A2**<br>Krijimi i Zonave të reja BID në Bashkinë Shkodër. | **<u>Llojet e programit</u>: P6** Zhvillimi ekonomik lokal dhe turizmi.<br>**Funksioni P6.F5.** Dhënia e granteve dhe ndihmave financiare për mbështetjen e aktiviteteve të biznesit të vogël dhe të mesëm, sipas mënyrës së përcaktuar në legjislacionin në fuqi. |
|---|---|---|

**a) Përshkrim i shkurtër i projektit**

**i. Situata**

Në vazhdim të bashkëpunimit që Bashkia Shkodër ka me AADF (Fondacioni i Zhvillimit Shqiptaro–Amerikan) me projektin "BID Shkodra" përgjatë rrugëve "13 Dhjetori", "28 Nëntori" dhe "Kolë Idromeno", si dhe duke u nisur nga interesimi që bizneset e rrugës "Hamz Kazazi" (zona Zdrale), kanë shfaqur për të krijuar zonën e tyre BID (Zona e Përmirësimit të Biznesit), Bashkia Shkodër do të mbështesë iniciativën e tyre për të krijuar një zonë të re. Rruga "Hamz Kazazi" ka përfaqësuar historikisht tregun "Zdrale". Ky treg është një nga dy tregjet kryesore të Shkodrës. Aktivitetet tregtare variojnë nga ato me pakicë në ato me shumicë. Projekti do të ketë një ndikim të rëndësishëm social-ekonomik për banorët e Shkodrës duke kontribuar në përmirësimin e aksesit ndaj shërbimeve bazë dhe tregjeve.

**ii. Synimi i projektit**

Mbështetja e sa më shumë bizneseve për të konsoliduar dhe rritur aktivitetin e tyre ekonomik, nëpërmjet përmirësimit të cilesisë së shërbimeve të zonës së përmirësimit të biznesit, për ta kthyer atë në një vend tërheqës për vizitorin.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

1. Aprovimi në këshillin e Bashkisë Shkodër të kërkesës për krijimin e Zonës së Përmirësimit të Biznesit përgjatë rrugës "Hamz Kazazi" (Zona Zdrale).
2. Themelimi i Zonës së Përmirësimit të Biznesit përgjatë rrugës "Hamz Kazazi" (Zona Zdrale).
3. Bashkia Shkodër do të mbështesë me mjete financiare nëpërmjet transferimit të të ardhurave nga tarifat, që mblidhen nga Bashkia Shkodër, nga bizneset anëtare të shoqatës.

**b) Rezultatet që prisni**

Krijimi i Zonës së re të Përmirësimit të Biznesit përgjatë rrugës "Hamz Kazazi" (Zona Zdrale).
Rritja e cilësisë së shërbimit për vizitorin, të bizneseve që ndodhen përgjat rrugës "Hamz Kazazi".

| c) Aktorët e mundshëm | d) Kontributet e mundshme në projekt |
|---|---|
| Bashkia Shkodër<br>AADF | Bashkia Shkodër |

**e) Shpenzimet e llogaritura**

| | Shpenzimet për çdo aktivitet 2018 | Totali (000 lek) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Lobim dhe koordinim në mbështetje të procesit për krijimin e zonës BID në rrugën "Hamz Kazazi" (Zona Zdrale). | | | | | | |
| **Shuma** | | | | | | | |

| | Shpenzimet për çdo aktivitet 2019 | Totali (000 lek) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Transferimi i të ardhurave nga tarifat që mblidhen nga Bashkia Shkodër, nga bizneset anëtare të shoqatës, të percaktuara sipas listes së aprovuar. | **1,000** | | | | 1,000 | |
| **Shuma** | | **1,000** | | | | **1,000** | |

| | Shpenzimet për çdo aktivitet 2020 | Totali (000 lek) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | operative | Transferime | kapitale |
| A.1 | Transferimi i të ardhurave nga tarifat, që mblidhen nga Bashkia Shkodër, nga bizneset anëtare të shoqatës të percaktuara sipas listes së aprovuar. | **1,000** | | | | 1,000 | |
| **Shuma** | | **1,000** | | | | **1,000** | |

| f) Periudha e zbatimit | g) Pergatiti dhe ndjek realizimin e projektit: |
|---|---|
| **2018**<br>**2019**<br>**2020** | Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit<br>Institucioni likujdues:Bashkia Shkoder |

<table>
<tr><td>Nr.23</td><td>P6.F5.O1.A3.<br>Nxitja e investimeve në kërkim dhe zhvillim me qëllim ngritjen e kompanive të reja (Start Up) dhe zhvillimin e SME-ve ekzituese.</td><td colspan="6"><u>Llojet e programit</u> :P6 Zhvillimi ekonomik lokal dhe turizmi.<br>Funksioni P6.F5 Dhënia e granteve dhe ndihmave financiare për mbështetjen e aktiviteteve të biznesit të vogël dhe të mesëm, sipas mënyrës së përcaktuar në legjislacionin në fuqi.</td></tr>
<tr><td colspan="8">a) Përshkrim i shkurtër i projektit</td></tr>
<tr><td colspan="8">i. Situata</td></tr>
<tr><td colspan="8">Qytetet si qendra investimesh janë motorët e rritjes së zhvillimit ekonomik. Shkodra ka nevojë për rritjen e numrit të sipërmarrjeve, Start Up dhe SME-ve, si një mundësi për rritjen e zhvillimit ekonomik të 11 njësive administrative të saj. Aksesi i dobët nga ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në burimet e financimit, mungesa e inkubatorëve të biznesit dhe e formalizimit të klasterave të biznesit, informaliteti në ekonomi, problemet me të drejtën e pronësisë etj, janë faktorë të cilët frenojnë zhvillimin e SME-ve ekzistuese dhe krijimin e sipërmarrjeve të reja Start-Up. Vihet re një rritje e numrit të këtyre sipërmarrjeve pas krijimit të programeve të ndryshme të ofruara përmes AIDA-s, por mungesa e burimeve njerëzore profesionale për përfitimin e burimeve të financimit nga këto programe sjell barriera që sipërmarrjet të përftiojnë nga këto fonde. Me qëllim nxitjen e investimeve dhe rritjen e aksesit për përfitimet e këtyre fondeve nga ndërmarrjet, Bashkia Shkodër ka krijuar paketa informuese për subjektet e interesuara dhe ofron shërbimin e informacionit dhe këshillimit të tyre.</td></tr>
<tr><td colspan="8">ii. Synimi i projektit</td></tr>
<tr><td colspan="8">Ky projekt synon promovimin ekonomik, nxjitjen e punësimit, krijimin e kompanive të reja Start Up dhe zhvillimin e SME-ve ekzistuese.</td></tr>
<tr><td colspan="8">iii. Aktivitetet kryesore të projektit</td></tr>
<tr><td colspan="8">1. Ofrimi i shërbimeve të informacionit dhe këshillimit;<br>2. Mbështetja e këtyre ndërmarrjeve dhe nxitja e bashkëveprimit ndërmjet tyre;<br>3. Dhënia me qira e pasurive të paluajtshme në pronësi të Bashkisë dhe përmiresimi i kushteve të tyre.</td></tr>
<tr><td colspan="8">b) Rezultatet që prisni</td></tr>
<tr><td colspan="8">Ngritja e sipërmarrjeve të reja Start Up dhe rritja e numrit të SME-ve.</td></tr>
<tr><td colspan="2">c) Aktorët e mundshëm</td><td colspan="6">d) Kontributet e mundshme në projekt (kush do të kontribuojë për këtë projekt, financiarisht etj.)</td></tr>
<tr><td colspan="2">Bashkia Shkodër<br>Dhoma e Tregtisë<br>AIDA dhe programe të tjera të BE-së për nxitjen e biznesit</td><td colspan="6">Bashkia Shkodër</td></tr>
<tr><td colspan="8">e) Shpenzimet e llogaritura</td></tr>
<tr><td colspan="2" rowspan="2">Shpenzimet per çdo aktivitet</td><td rowspan="2">Totali (000 lek)</td><td colspan="5">Nga kjo:</td></tr>
<tr><td>Paga</td><td>Sigurime</td><td>Operative</td><td>Transferime</td><td>Kapitale</td></tr>
<tr><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr>
<tr><td colspan="2">f) Periudha e zbatimit<br>2018<br>2019<br>2020</td><td colspan="6">g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:<br>Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit<br>Institucioni likujdues:Bashkia Shkoder</td></tr>
</table>

<table>
<tr><td>Nr.24</td><td colspan="6">P6.F5.O1.A4.<br>Mbështetja dhe lehtësimi i bizneseve për aplikime në programet dhe skema të ndryshme financiare</td><td colspan="5"><u>Llojet e programit</u> :P6 Zhvillimi ekonomik lokal dhe turizmi.<br>Funksioni P6.F5 Dhënia e granteve dhe ndihmave financiare për mbështetjen e aktiviteteve të biznesit të vogël dhe të mesëm, sipas mënyrës së përcaktuar në legjislacionin në fuqi.</td></tr>
<tr><td colspan="12">a) Përshkrim i shkurtër i projektit</td></tr>
<tr><td colspan="12">i. Situata</td></tr>
<tr><td colspan="12">Bizneset ekzistuese në Shkodër kanë hasur vështirësi për të aplikuar në programet dhe në skemat e ndryshme financiare qeveritare. Kjo ka ardhur si rezultat i mungesës së informacionit dhe gjithashtu vështirësive që hasin në plotësimin e dokumantacionit ligjor, sipas udhëzimeve të përcaktuara nga ministria e linjës apo edhe nga rregulloret e programve të ndryshme. Programet mbështetëse dhe instrumentat financiare qeveritare janë një mënyrë e mirë për rritjen e konkurrencës në sektorin e bujqësisë dhe industrisë ushqimore, në rritjen e qëndrueshmërisë ekonomike të zonave malore të disavantazhuara, rritjen e ekonomisë lokale nga njëra anë dhe nga ana tjetër përforcimi i marrëdhënieve ekonomike me Bashkimin Europian, mbrojtjen e mjedisit, nxitjen e transportit të qëndrueshëm dhe të infrastrukturës publike etj.</td></tr>
<tr><td colspan="12">ii. Synimi i projektit</td></tr>
<tr><td colspan="12">Shtimi i bizneseve që aplikojnë në mënyrë të suksesshme për të përfituar nga programet dhe skemat e ndryshme financiare shtetërore.</td></tr>
<tr><td colspan="12">iii. Aktivitetet kryesore të projektit</td></tr>
<tr><td colspan="12">1. Ofrimi i shërbimeve për dhënie informacioni dhe këshillim;<br>2. Azhornimi i paketave informuese në lidhje me programet dhe skemat e ndryshme financiare për të cilat mund të jenë të interesuar subjektet e ndryshme;<br>3. Asistenca për plotësimin e dokumentacionit për aplikim.</td></tr>
<tr><td colspan="12">b) Rezultatet që prisni</td></tr>
<tr><td colspan="12">Rritja e numrit të bizneseve që përfitojnë nga programet dhe skemat e ndryshme financiare.</td></tr>
<tr><td colspan="7">c) Aktorët e mundshëm</td><td colspan="5">d) Kontributet e mundshme në projekt</td></tr>
<tr><td colspan="7">Bashkia Shkodër<br>Dhoma e Tregtisë<br>AIDA</td><td colspan="5">Bashkia Shkodër</td></tr>
<tr><td colspan="12">e) Shpenzimet e llogaritura</td></tr>
<tr><td colspan="2" rowspan="2">Shpenzimet për çdo aktivitet</td><td rowspan="2">Totali (000 lek)</td><td colspan="5">Nga kjo:</td></tr>
<tr><td>Paga</td><td>Sigurime</td><td>Operative</td><td>Transferime</td><td>Kapitale</td></tr>
<tr><td>A.1</td><td>Ofrimi i shërbimeve për dhënie informacioni dhe këshillim.</td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr>
<tr><td>A.2</td><td>Azhornimi i paketave informuese në lidhje me programet dhe skemat e ndryshme financiare për të cilat mund të jenë të interesuar subjektet e ndryshme.</td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr>
<tr><td>A.3</td><td>Asistenca për plotësimin e dokumentacionit për aplikim.</td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr>
<tr><td></td><td>Shuma</td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr>
<tr><td colspan="2">f) Periudha e zbatimit<br>2018<br>2019<br>2020</td><td colspan="6">g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:<br>Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit<br>Institucioni likujdues:Bashkia Shkoder</td></tr>
</table>

| | | |
|---|---|---|
| **Nr. 25** | **P6.F6.O1.A1.**<br>Krijimi i faqes web për turizmin e rajonit të Shkodrës, hostim, mirëmbajtje, përditësim dhe shërbime shtesë për web sitin e turizmit. | **Llojet e programit: P6:** Zhvillimi ekonomik dhe i Turizmit<br><br>**Funksioni: P6:F6:** Turizëm |

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit**

**i. Situata**

Një ndër instrumentët më të fuqishëm është promovimi online. Promocioni online ofron avantazhe të shumta dhe është lehtësisht i arritshëm nga çdo pikë e globit, mund të përditësohet shpejt, është i lirë etj. Mundësia unike që ka web-i për të bashkuar tekstet, figurat, foto, tingujt, videoklipet në një dokument multimedia, kanë rritur përdorimin në një shkallë të lartë kundrejt mediave të tjera tradicionale, duke e kthyer atë në një media globale. Web-i ofron potenciale të mëdha për marketingun dhe nga ana tjetër shumë aspekte të marketingut në internet bazohen në web. Web-i, dixhitalizimi i të dhënave dhe përdorimi në masë i kompjuterave personalë kanë krijuar mjedisin e tregtisë elektronike, në të cilin teknikat e marketingut tradicional janë transformuar pjesërisht. Aktualisht Bashkia Shkodër ka një website zyrtar që i dedikohet turizmit. Ky portal përmban materiale promocionale dhe të gjithë informacionin e nevojshëm për vizitorët që dëshirojnë të vinë në Shkodër. Duke pasur parasysh ritmet e zhvillimit të turizimit, tendencat e vazhdueshme për produkte të reja, është i nevojshëm azhornimi i vazhdueshëm i informacioneve të faqes web për turizmin e Bashkisë Shkodër.

ii**. Synimi i projektit**

Synohet promovimi i vlerave të veçanta të destinacionit tonë turistik si dhe përmirësimi i informacionit për vizitorët.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

1. Module shtesë
2. Mirëmbajtje
3. Hostim

**b) Rezultatet që prisni**

Mirëmbajtja dhe përditësimi i Website-it, dedikuar turizmit të Bashkisë Shkodër

| **c) Aktorët e mundshëm** | **d) Kontributet e mundshme në projekt** |
|---|---|
| Stafi i Bashkisë. (Drejtoria e Turizmit, Drejtoria e të Ardhurave, Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit, etj)<br>Universiteti i Shkodrës | Bashkia Shkodër.<br>Bizneset përfituese të turizmit.<br>ATA |

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2018** | | Totali (mije lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Module shtesë; Mirëmbajtje e faqes web; Hostim | | | | **80** | | |
| | **Shuma** | **80** | | | **80** | | |

| **f) Periudha e zbatimit**<br>**2018**<br>**2019**<br>**2020** | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**<br>Drejtoria e Turizmit<br>Institucioni likujdues:Bashkia Shkoder |
|---|---|

| Nr. 26 | **P6.F6.O1.A2.**<br>Konceptim dhe krijim i një aplikacioni për smartphone që shërben për informimin dhe orientimin e vizitorëve. | **Llojet e programit: P6:** Zhvillimi ekonomik dhe i Turizmit<br><br>**Funksioni: P6:F6:** Turizëm**.** |
|---|---|---|

**a) Përshkrim i shkurtër i projektit**

**i. Situata**

Numri i lartë i përdoruesve të internetit në ditët e sotme, bën që marketingu online të jetë i një rëndësie shumë të lartë. Një arsye tjetër është ulja e kostove duke bërë marketing në një formë shumë efikase dhe në një kohë relativisht jo të gjatë. Mendimi i parë i çdo individi, kur kërkon të ketë një shërbim apo informacion, është ta kërkojë në internet. Për të promovuar territorin e Bashkisë Shkodër si destinacion turistik dhe përmirësuar cilësinë e shërbimit për turistët, krijimi i një aplikacioni për smartphone, i cili deri tani mungonte, me informacionet dhe orientimet e nevojshme drejt nevojave të vizitorëve, është i domosdoshëm. Ofrimi i informacionit online përmes rrjeteve socialeve, web-it, aksesi për shkarkimin falas të gjithë materialeve promocionale të territorit përmes aplikacionit do të ketë një impakt pozitiv në rritjen e numrit të vizitorëve dhe do ndikojë në zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm.

ii. Synimi i projektit

Të përmirësojë aksesin e marrjes së informacionit për vizitorët.

iii. Aktivitetet kryesore të projektit

1. Konceptimi i aplikacionit
2. Krijimi i aplikacionit
3. Mirëmbajtja dhe përditësimi i tij.

**b) Rezultatet që prisni**

Krijimi i Aplikacionit për Smartphone si një instrument informacioni lehtësisht i arritshëm.

| **c) Aktorët e mundshëm** | **d) Kontributet e mundshme në projekt** |
|---|---|
| Stafi i Bashkisë.(Drejtoria e Turizmit, Drejtoria e Bujqësisë<br>Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit, etj)<br>Agjencia Kombëtare e Turizmit | Bashkia Shkodër.<br>Bizneset përfituese të turizmit.<br>Shoqata e Artizanëve<br>ATA |

**e) Shpenzimet e llogaritura**

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2018** | | Totali (mije lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Dizenjimi i aplikacionit për smartphone; Mirëmbajtje e aplikacionit; Hostim i aplikacionit në Google Play dhe/ose App Store | | | | 350 | | |
| | **Shuma** | **350** | | | **350** | | |

| **f) Periudha e zbatimit**<br>**2018**<br>**2019**<br>**2020** | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**<br>Drejtoria e turizmit<br>Institucioni likujdues:Bashkia Shkoder |
|---|---|

| | | |
|---|---|---|
| **Nr. 27** | **P6.F6.O1.A3.**<br>Përgatitja dhe publikimi i guidës turistike të Bashkisë Shkodër. Përditësim dhe ribotim i guidës turistike të Bashkisë Shkodër | **Llojet e programit P6:** Zhvillimi ekonomik dhe i Turizmit<br><br>**Funksioni P6:F6:** Turizëm |

**a) Pershkrimi i shkurter i projektit**

**i. Situata**

Bashkia Shkodër ka potencial të madh për zhvillimin e turizmit. I gjithë territorri karakterizohet nga një shumëllojshmëri atraksionesh turistike, që nga bukuritë natyrore te ndërtesat historike dhe identitetet kulturore. Pozita e favorshme gjeografike është pa dyshim një pasuri e rëndësishme për zhvillimin turistik të saj. Traditat njerëzore, kulturore dhe historike ia shtojnë më shumë vlerën këtij potenciali. Gjatë viteve të fundit, numri i turistëve që vizitojnë Shkodrën është rritur në mënyrë të qëndrueshme. Si rezultat i zgjerimit të territorit të Bashkisë Shkodër, një vëmendje e vecantë i është kushtuar pritjes së turistëve dhe marketingut të ofertës turistike. Në këtë kuadër Bashkia Shkodër ka përgatitur dhe botuar guidën turistike të territorit, material i cili kërkon përditësim të të dhënave dhe shtim informacioni të herëpashershëm. Me hapjen e tre zyrave të informacionit në Shkodër, Velipojë dhe Theth, interesimi i vizitorëve pranë këtyre zyrave është gjithnjë e në rritje dhe përgatitja e materialeve promocionale dhe shpërndarja e tyre, është shumë i rëndësishëm. Për këtë arsye, është e nevojshme që ky produkt të ribotohet herë pas here.

**ii. Synimi i projektit**

Të promovojë territorin e Bashkisë Shkodër si destinacion turistik, përmes prodhimit të materialeve promocionale.

**iii. Aktivitetet kryesore te projektit**

1. Përditësimi i të dhënave dhe informacioneve për përmbajtjen e materialit.
2. Design dhe ribotimi i guidës.

**b) Rezultatet qe prisni**

Një guidë turistike e Bashkisë Shkodër me të gjithë informacionin e nevojshëm për vizitorin

| **c) Aktoret e mundshem** | **d) Kontributet e mundshme ne projekt** |
|---|---|
| Stafi i Bashkisë Shkodër<br>Dega e Turizmit të Fakultetit Ekonomik të USH<br>Bizneset përfituese të turizmit. | Bashkia Shkodër. |

e) Shpenzimet e llogaritura

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2018** | | Totali (mije lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Përditësimi të dhënave dhe informacioneve për përmbajten e guidës; Design dhe ribotim i guidës | | | | **350** | | |
| | **Shuma** | **350** | | | **350** | | |

| | |
|---|---|
| **f) Periudha e zbatimit**<br>**2018**<br>**2019**<br>**2020** | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**<br>Drejtoria e Turizmit<br>Institucioni likujdues:Bashkia Shkoder |

| Nr. 28 | **P6.F6.O1.A4.**<br>Ribotim i hartës turisitike së territorit të Bashkisë. | **Llojet e programit: P6:** Zhvillimi ekonomik dhe i Turizmit<br><br>**Funksioni: P6:F6:** Turizëm |
|---|---|---|

**a) Pershkrimi i shkurter i projektit**

**i. Situata**

Zona e Shkodrës gjithnjë e më tepër po tërheq vizitorë nga shtete të ndryshme të botës. Këto vizitorë shpesh kanë nevojë për të marrë informacion për vendet me interes dhe mënyrën se si mund të arrihet atje. Me ndryshimet territoriale të territorit administrativ të Bashkisë Shkodër, është botuar një harte të re, por për të plotësuar nevojat e vizitorëve potencial të Bashkisë, duhet të përditësohet vazhdimisht informacioni dhe te shtohet numri i kopjeve te botuara. Kjo hartë do të vihet në dispozicion të vizitorëve nga Zyra e Informacionit Turistik të Bashkisë.

**ii. Synimi i projektit**

Synohet përmirësimi cilësor dhe sasior i informacionit për vizitorët.

**iii. Aktivitetet kryesore te projektit**

1. Përditësimi i informacionit.
2. Dizenjimi dhe ilustrimi.
3. Ribotimi i hartës.

**b) Rezultatet qe prisni**

Hartë e përditësuar për turistët.

| **c) Aktoret e mundshem** | **d) Kontributet e mundshme ne projekt** |
|---|---|
| Stafi i Bashkisë.(Sektori i Marketingut dhe i Shërbimit ndaj Vizitorit, Sektori i Prokurimeve Publike, etj)<br>Dega e Turizmit të Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Shkodrës.<br>Bizneset përfituese të turizmit. | Bashkia Shkodër. |

**e) Shpenzimet e llogaritura**

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2018** | | Totali (mije lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Ribotim i hartës (përditësim i informacionit, dizenjim, ilustrim, | | | | 350 | | |
| | **Shuma** | **350** | | | **350** | | |

| **f) Periudha e zbatimit**<br>**2018**<br>**2019**<br>**2020** | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**<br>Drejtoria e turizmit<br>Institucioni likujdues:Bashkia Shkoder |
|---|---|

| Nr.29 | **P6.F6.O1.A5.**<br>Publikimi i kalendarit vjetor të aktiviteteve kulturore të Bashkisë. | **Llojet e programit: P6:** Zhvillimi ekonomik dhe i Turizmit<br><br>**Funksioni: P6:F6:** Turizëm |
|---|---|---|

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit**

**i. Situata**

Në territorin aktual të Bashkisë Shkodër zhvillohen një seri ngjarjesh dhe aktivitetesh social-kulturore, sportive etj. Pjesa më e madhe e tyre e organizuar në mënyrë të drejtpërdrejtë ose e mbështetur në mënyra të ndryshme nga Bashkia. Një pjesë e tyre janë aktivitete me pjesmarrje të gjërë dhe me potencial të konsiderueshëm, për të tërhequr vizitorë edhe nga trevat e tjera të Shqipërisë e më gjerë. Ribotimi i kalendarit të eventeve kulturore kontribuon ndjeshëm në informimin në kohë të vizitorëve potencialë. Gjithashtu informacioni i mbledhur dhe i sistemuar me këtë rast do të publikohet në faqen web të Bashkisë Shkodër.

**ii. Synimi i projektit**

Promovimi dhe përmirësimi i informacionit për ngjarjet kulturore në Bashkinë Shkodër.

**iii. Aktivitetet kryesore te projektit**

1. Mbledhja e informacionit për aktivitetet që zhvillohen periodikisht në territorin e Bashkisë Shkodër.
2. Botimi dhe shpërndarja e kalendarëve.

**b) Rezultatet qe prisni**

Rritja e pjesëmarrjes në aktivitetet e organizuara nga Bashkia Shkodër si edhe përmirësimi i informacionit turistik.

| **c) Aktoret e mundshem** | **d) Kontributet e mundshme ne projekt** |
|---|---|
| Stafi i Bashkisë.(Sektori i Marketingut dhe i Shërbimit ndaj Vizitorit, Sektori i Prokurimeve Publike, Zyra e Kulturës, Institucionet kulturore të varësisë, etj) | Bashkia Shkodër.<br>Bizneset përfituese të turizmit. |

**e) Shpenzimet e llogaritura**

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2018** | | Totali (mije lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Botimi i kalendarit | | | | 120 | | |
| | **Shuma** | **120** | | | **120** | | |

| **f) Periudha e zbatimit**<br>**2018**<br>**2019**<br>**2020** | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**<br>Drejtoria e turizmit<br>Institucioni likujdues:Bashkia Shkoder |
|---|---|

| Nr. 30 | **P6.F6.O1.A6.**<br>Prodhimi i materialeve promocionale të tilla si dosje, stilolapsa, çanta, çakmakë etj**.** | **Llojet e programit P6:** Zhvillimi ekonomik dhe i Turizmit<br><br>**Funksioni P6:F6:** Turizëm |
|---|---|---|

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit**

**i. Situata**

Materiale të ndryshme promocionale si dosje, stilolapsa, çanta, çakmakë etj, janë materiale që kanë kosto të lirë por ndikim të madh në promovimin e një destinacioni të caktuar. Për të promovuar turizmin në destinacion, janë mjaft me vlerë edhe materialet promocionale, të cilat në shpërndarjen e tyre lënë një imazh të destinacionit. Është e rëndësishme që prezantimet apo takimet që do bëhen nga stafi i drejtorisë së turizmit, të kenë mjetet e nevojshme identifikuese.

**ii. Synimi i projektit**

Më anë të këtij projekti synohet të shumfishohen materialet promocionale dhe identifikuese te Bashkisë Shkodër në zhvillimin e turizmit .

**iii. Aktivitetet kryesore tëprojektit**

1. Zgjedhja e materialeve për promocion
2. Printimi i materialit promocional.

*Materialet promocionale i vihen në dispozicion Sektorit të Marketingut dhe Shërbimit ndaj Vizitorit për t'iu ofruar vizitorëve dhe personave të tjerë të interesuar.*

**b) Rezultatet që prisni**

Promovimi i territorit të Bashkisë Shkodër si destinacion turistik.

| **c) Aktorët e mundshëm** | **d) Kontributet e mundshme në projekt** |
|---|---|
| Stafi i Bashkisë.(Sektori i Marketingut dhe i Shërbimit ndaj Vizitorit, Sektori i Prokurimeve Publike, etj | Bashkia Shkodër. |

**e) Shpenzimet e llogaritura**

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2018** | | Totali (mije lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Prodhim i materialeve promocionale të tilla si dosje, stilolapsa, çanta, çakmake etj. | | | | 200 | | |
| | **Shuma** | **200** | | | 200 | | |

**f) Periudha e zbatimit**
**2018**
**2019**
**2020**

**g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**
Drejtoria e Turizmit
Institucioni likujdues:Bashkia Shkoder

| Nr. 31 | **P6.F6.O1.A7** Pergatitja dhe publikimi i itinerareve turistike | **Llojet e programit P6:** Zhvillimi ekonomik dhe i Turizmit<br><br>**Funksioni P6:F6:** Turizëm |
|---|---|---|

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit**

**i. Situata**

Nëse organizoni planet tuaja të udhëtimit, një itinerar turistik është një nga komponentet kyç për të qëndruar i organizuar dhe i aftë për të maksimizuar kohën e pushimeve tuaja. Veçanërisht për ata që duan të bëjnë nje udhetim vetëm, itinerari mund të shërbejë si një udhërrëfyes që përmban informacion të hollësishëm dhe themelor rreth destinacionit tuaj. Planifikimi i itinerarit duhet të bëhet me kujdes, pasi janë shumë detaje që duhet të konsiderohen sic janë; koha, ushqimi, moti, akomodimi, shëtitja etj. Si një mënyrë lehtësimi dhe organizimi për turistet që zgjedhin Shkodrën si destinacionin e tyre turistik, është menduar përgatitja dhe publikimi i disa itinerarëve turistikë që do të krijojnë shumë lehtësira dhe do të rrisin kënaqësinë gjatë qëndrimit.

**ii. Synimi i projektit**

Promovimimi atraksioneve turistike në territorin e Bashkisë Shkodër.

**iii. Aktivitetet kryesore tëprojektit**

1. Vlerësimi dhe studimi i kërkesava nga ana e turistëve
2. Përpunimi i informacionit.
3. Konceptimi dhe krijimi i itinerarëve turistik.
4. Publikimi i itinerarëve turistikë

**b) Rezultatet që prisni**

Rritja e numrit te turistëve dhe zgjatja e kohëqendrimit të tyre në Shkodër.

| **c) Aktorët e mundshëm** | **d) Kontributet e mundshme në projekt** |
|---|---|
| Stafi i Bashkisë<br>Dega e Turizmit të Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Shkodrës.<br>Bizneset përfituese të turizmit. | Bashkia Shkodër |

**e) Shpenzimet e llogaritura**

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2018** | | Totali (mije lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Pergatitja dhe publikimi i itinerareve turistike | | | | 200 | | |
| | **Shuma** | **200** | | | 200 | | |

| **f) Periudha e zbatimit**<br>**2018**<br>**2020** | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**<br>Drejtoria e Turizmit<br>Institucioni likujdues:Bashkia Shkoder |
|---|---|

| Nr.32 | **P6.F6.O2.A1.**<br>Panairi i artizanatit në diten ndërkombëtare të artizanatit. | **Llojet e programit: P6**: Zhvillimi ekonomik dhe i Turizmit<br><br>**Funksioni: P6:F6:** Turizëm |
|---|---|---|

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit**

**i. Situata**

Territori i Bashkisë Shkodër të ofron lloje të ndryshme turizmi. Një pikë e fortë e jona me të cilën mund të konkurojmë denjësisht edhe në nivele ndërkombëtare është artizanati. Në një situatë në të cilën zhvillimi ekonomik dhe rritja e mirëqënies po çojnë dalëngadalë drejt humbjes së interesit për punimet artizanale dhe zbehjen e rëndësisë së tyre si aktivitet ekonomik,për shkak të rritjes së interesit të vizitorëve dhe të turistëve të shumtë që vizitojnë qytetin për punimet artizanale dhe suveniret, lind nevoja që këto zeje dhe zanate të promovohen dhe të mbështeten si një element tërheqës dhe burim turistik. Punimet e qytetit të Shkodrës dhe të zonave përreth mbeten një suvenir i mrekullueshëm sapo viziton këtë qytet. Panairi është një instrument i fuqishëm që ndikon drejtpërdrejtë ne promovimin e ketyre vlerave qe ka Bashkia Shkodër.

**ii. Synimi i projektit**

Të promovojë dhe të mbështesë artizanatin në Bashkinë Shkodër.

iii. Aktivitetet kryesore të projektit

1. Konceptimi i panairit në të gjithë elementët e tij.
2. Organizimi i aktivitetit me pjesëmarrjen e bizneseve të Shkodrës.
3. Publikim i një materiali informativ me produktet që dalin nga panairi.

**b) Rezultatet që prisni**

Rritja e interesit për prodhimin e produkteve artizanale si dhe rritja e atraktivitetit.

| **c) Aktorët e mundshëm** | **d) Kontributet e mundshme në projekt** |
|---|---|
| Stafi i Bashkisë.(Sektori i Marketingut dhe i Shërbimit ndaj Vizitorit, Sektori i Prokurimeve Publike, etj).<br>Shoqata e Artizanëve të Shqipërisë. | Bashkia Shkodër. |

e) Shpenzimet e llogaritura

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2018** | | Totali (mije lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Organizim i panairit (baner, postera, kartolina, transport, montim, qera, foni, Dj, etj ). | | | | 350 | | |
| | **Shuma** | **350** | | | **350** | | |

| **f) Periudha e zbatimit**<br>**2018**<br>**2019**<br>**2020** | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**<br>Drejtoria e Turizmit<br>Institucioni likujdues:Bashkia Shkoder |
|---|---|

| Nr. 34 | **P6.F6.O2.A3.**<br>Pjesmarrje në panaire kombëtare dhe ndërkombëtare për ofertën turistike të Shkodrës | **Llojet e programit: P6**: Zhvillimi ekonomik dhe i Turizmit<br><br>**Funksioni: P6:F6:** Turizëm |
|---|---|---|

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit**

**i. Situata**

Territori i Shkodrës ofron potenciale të shumta për zhvillimin e shumë llojeve të turizmit duke filluar që nga ai detar, kulturor, familjar-mjedisor, malor, të aventurës etj. Zhvillimi i turizmit në zonën e Shkodrës, në vitet e fundit ka ecur me shpejtësi. Nga viti në vit, numri i turistëve dhe vizitorëve ka ardhur në rritje. Vizitorët e qytetit të Shkodrës janë kryesisht nga Evropa Perëndimore dhe Veriore por vitet e fundit vihet re një prani e shtuar e vizitorëve nga Evropa Qendrore dhe Lindore. Gjithashtu një numër të madh të vizitorëve e përbëjnë vizitorët etnikë nga Maqendonia, Mali i Zi dhe kryesisht nga Kosova. Gjithashtu rajoni jonë ofron një gamë të gjerë të produkteve bujqësore dhe gastronomike me shije krejt të veçanta, që përbëjnë një element shumë të rëndësishëm të ofertës turistike të rajonit. Një sinergji më e konsoliduar mes bizneve turistike dhe atyre të produkteve
bujqësore dhe gastronomike do të krijonte mundësinë për produkte të reja turistike duke rritur ndjeshëm numrin e tyre por edhe duke i përmirësuar cilësisht ato. Të gjithë këto vlera të qytetit tonë do ishte e mirë të njiheshin ndërkombëtarisht dhe pjesëmarrja në panaire kombëtare dhe ndërkombëtare është një alternativë mjaft e mirë për këtë qëllim.

**ii. Synimi i projektit**

Me pjesëmarrjen në panaire të ndryshme synohet të promovohet Bashkia Shkodër për vlerat turistike në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

1. Mbledhja dhe sistemimi i informacionit për materialin që do prezantohet në panaire.
2. Prodhimi i materialeve promocionale per stendën e panairit.
3. Pjesëmarrja në panaire.

**b) Rezultatet që prisni**

Vizitorët që marrin pjesë në panair do të kenë një informacion më të plotë për atraksionet dhe produktet turistike të territorit të Bashkisë Shkodër.

| **c) Aktorët e mundshëm** | **d) Kontributet e mundshme në projekt (kush do të kontribuojë për këtë projekt, financiarisht etj.)** |
|---|---|
| Stafi i Bashkisë. (Drejtoria e Turizmit, Drejtoria e të Ardhurave, Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe përmirësimit të klimës së biznesit, etj) | Bashkia Shkodër.<br>Bizneset përfituese të turizmit.<br>Shoqata e Artizanëve |

e) Shpenzimet e llogaritura

| | **Shpenzimet për çdo aktivitet 2018** | Totali (mije lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Pjesmarrje në panair (Organizim, baner, fletëpalosje, stendë panairi, transport, qera hapësire, bileta | | | | 550 | | |
| | **Shuma** | **550** | | | **550** | | |

| **f) Periudha e zbatimit**<br>**2018**<br>**2019**<br>**2020** | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**<br>Drejtoria e Turizmit<br>Institucioni likujdues:Bashkia Shkoder |
|---|---|

| Nr.39 | **P6.F6.O3.A.4**<br>Festa e Thethit | **Llojet e programit: P6:** Zhvillimi ekonomik dhe i Turizmit<br><br>**Funksioni: P6:F6:** Turizëm |
|---|---|---|

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit**

**i. Situata**

Zona e Thethit është një nga destinacionet më atraktive të territorit të Bashkisë Shkodër e më gjërë. E gjendur në zemër të Alpeve ofron mundësi të shumta për zhvillimin e llojeve të ndryshme të turizmit sidomos atij malor dhe të aventurës. Vitet e fundit Thethi është konsoliduar si destinacion turistik malor dhe zhvillimi i turizmit është gjithnjë në rritje. Me ndryshimin e reformës territoriale administrative dhe kalimin e këtij territori nën administrimin e Bashkisë Shkodër, lind nevoja e një promovimi më të organizuar në mënyrë që të rritet akoma më shumë numri i vizitorëve në Theth. Për këtë është menduar organizmi i një feste
që do të çelë sezonin turistik në Theth dhe që përkon edhe me një traditë të fshatit që quhet "Dalja në Bjeshkë". Kjo festë ka për qëllim të promovojë Thethin si destinacion turistik edhe tek vizitorët vendas pasi aktualisht ata përbëjnë vetëm një pjesë të vogël të turizmit në Theth.

**ii. Synimi i projektit**

Promovimi i vlerave natyrore turistike të fshatit Theth.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

Organizimi i Festës me të gjithë komponentët e saj :

1. Lajmerime dhe botime promocionale për festen
2. Program artistik
3. Shpenzime logjistike për ngritjen dhe funksionimin e panairit
4. Pjesmarrja e operatorëve turistik vendas dhe të rajonit, rrjetin e hotelerisë dhe restoranteve të Thethit.
5. Zhvillimi i Festës "Dalja në Bjeshkë"

**b) Rezultatet që prisni**

Promovimi i burimeve dhe atraksioneve turistike të Thethit nëpërmjet organizimit të Festës së Thethit

| **c) Aktorët e mundshëm** | **d) Kontributet e mundshme në projekt (kush do të kontribuojë për këtë projekt, financiarisht etj.)** |
|---|---|
| Bashkia Shkodër.<br>Bizneset përfituese të turizmit.<br>ATA<br>Dhoma e Tregtisë dhe industrisë<br>Universiteti i Shkodrës, Fakulteti i Turizmit. | Bashkia Shkodër. |

**e) Shpenzimet e llogaritura**

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2018** | | Totali (mije lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Organizimi i aktivitetit (program artistik me artistë të zones, , etj ) | | | | | 400 | |
| | **Shuma** | **400** | | | | **400** | |

| **f) Periudha e zbatimit (kur fillon, kur përfundon)**<br>**2018**<br>**2019**<br>**2020** | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**<br>Drejtoria e Turizmit<br>Institucioni likujdues:Bashkia Shkoder |
|---|---|

| Nr.40 | **P6.F6.O3.A5**<br>Dita e biçikletave | **Llojet e programit: P6:** Zhvillimi ekonomik dhe i Turizmit<br>**Funksioni: P6:F6:** Turizëm |
|---|---|---|

**a) Pershkrimi i shkurtër i projektit**

**i. Situata**

Shkodra është qyteti numër një në Shqipëri për përdorimin e biçikletës me një traditë të hershme të përdorimit të saj, që zë fill që në shekullin e 19. Gjithashtu Shkodra renditet në 10 qytetet që përdorin më shumë biçikletën në shkallë europiane. Gjatë
periudhës së dikataturës biçikleta ishte mjeti kryesor i transportit në Shkodër pasi numri i makinave ishte shumë i kufizuar. Me ardhjen e demokracisë dhe zhvillimin ekonomik numri i makinave ka ardhur vazhdimisht në rritje duke kërcënuar kështu zbehjen e kësaj tradite. Gjithashtu rritja e numrit të makinave rrezikon edhe ndotjen e ajrit nga gazrat dhe elementëve të tjerë të mjedisit nga mbetjet e tyre. Me organizimin e ditës së biçikletave dhe shndërrimin e saj në një festë të përvitshme synohet ripërtëritja e traditës si edhe promovimi i mënyrës së shëndetshme të jetesës por synohet edhe gjallërimi i jetës

**ii. Synimi i projektit**

Promovimi i përdorimit të biçikletës dhe gjallërimi i jetës social-kulturore të Shkodrës.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

1. Aktivitete të ndryshme me fokus biçikleten
2. Xhiro demostrative me bicikleta
3. Publikimi materialeve promocionale për përdorimin e biçikletës

*Procedura për zhvillimin e aktivitetit, do bëhet me thirrje publike, ku Këshilli artistik do gjykojë projektin më të mirë.*

**b) Rezultatet që prisni**

Realizimi i kësaj feste do të rrisë ndërgjegjësimin qytetar për përdorimin e biçikletës dhe do të krijojë një atmosferë festive në qytet.

| **c) Aktorët e mundshëm** | **d) Kontributet e mundshme në projekt (kush do të kontribuojë për këtë projekt, financiarisht etj.)** |
|---|---|
| Bashkia Shkoder<br>DAR<br>Klubi Shumësportësh Vllaznia | Bashkia Shkodër.<br>Shoqatat Mjedisore.<br>Shoqatat te sporteve te ndryshme. |

**e) Shpenzimet e llogaritura**

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2018** | | Totali (mije lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Organizimi i aktivitetit. (Printime të çertifikatave, bluzave, baner, kartolina, postera, transport materialesh, qera për | | | | | 350 | |
| | **Shuma** | **350** | | | | 350 | |

| **f) Periudha e zbatimit**<br>**2018**<br>**2019**<br>**2020** | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**<br>Subjekti aplikues<br>Drejtoria e Turizmit<br>Institucioni likujdues:Bashkia Shkoder |
|---|---|

| Nr.41 | **P6:F6:O3:A6.**<br>Aktiviteti “Triathlon Labeat” | **Llojet e programit: P6:** Zhvillimi ekonomik dhe i Turizmit: Funksioni<br><br>**P6:F6:** Turizëm |
|---|---|---|

**a) Pershkrimi i shkurtër i projektit**

**i. Situata**

Bashkia Shkodër, në kuadër të zhvillimit të sportit dhe turizmit në Liqenin e Shkodrës, organizon aktivitetin e përvitshëm “Triathlon” – një kompeticion tre garësh: not, çiklizëm dhe vrapim. Qëllimi i këtij aktiviteti është promovimi dhe nxitja e zhvillimit të sportit si një mënyrë e shëndetshme e të jetuarit. Aktiviteti karakterizohet nga pjesmarrja e gjerë e sportistëve dhe amatorëve të sportit nga qytete të ndryshme të Shqipërisë, rajonit dhe Europës. Aktivitete të tilla shërbejnë në promovimin e turzimit natyror në Liqenin e Shkodrës, si një aset i pazëvëndësueshëm i territorit dhe kontribuon në promovimin e burimeve dhe potencialeve që zotëron Liqeni i Shkodrës për zhvillimin e sporteve ujore dhe turizmit në tërësi.

**ii. Synimi i projektit**

Të nxisë zhvillimin e aktiviteteve sportive ujore
Të ndërgjegjësojë komunitetin për ruajtjen e mjedisit dhe pasurive ujore si Liqeni i Shkodrës.

iii. Aktivitetet kryesore të projektit ( Veprimet që do të ndermerrni për të prodhuar rezultate)

1. Sigurimi i infrastrukturës së nevojshme për realizimin e aktivitetit;
2. Zhvillimi i tre-garëshit: not-vrapim dhe çiklizëm
3. Shpallja e fituesve dhe ndarja e çmimeve

*Procedura për zhvillimin e aktivitetit, do bëhet me thirrje publike, ku komisioni artistik do gjykojë projektin më të mirë.*

**b) Rezultatet që prisni**

Ndërgjegjësim i rritur për vlerat sportive turistike dhe mjedisore të liqenit të Shkodrës.

| **c) Aktorët e mundshëm** | **d) Kontributet e mundshme në projekt** |
|---|---|
| Bashkia Shkodër.<br>DAR<br>Klubi Shumësportësh Vllaznia | Bashkia Shkodër.<br>Shoqatat Sportive |

e) Shpenzimet e llogaritura

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2018** | | Totali (mije lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Organizimi dhe zhvillimi i aktivitetit. (banera, postera, bluza, çertifikata, qera, transport, foni, Dj, moderator etj) | | | | | 350 | |
| | **Shuma** | **350** | | | | 350 | |

| **f) Periudha e zbatimit (kur fillon, kur përfundon)**<br>**2018**<br>**2019**<br>**2020** | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**<br>Drejtoria e Turizmit<br>Institucioni likujdues:Bashkia Shkoder |
|---|---|

| | | |
|---|---|---|
| **Nr.42** | **P6:F6:O3:A7.**<br><br>Aktiviteti: "Mbështetje për panairin e Ornitologjisë." | **Llojet e programit: P6:** Zhvillimi ekonomik dhe i Turizmit: Funksioni<br><br>**P6:F6:** Turizëm |

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit**

**i. Situata**

Ornitologjia është fusha shkencore e dedikuar për studimin e zogjve. Vitin e kaluar me date 28 Nëntor u zhvillua ne Tiranë për herë të parë në Shqipëri, "Festivali i Zogjve". Në këtë festival kishte pjesmarrje nga e gjithë Shqipëria, Kosova, Mali Zi, Maqedonia dhe Italia. Duke parë që ky festival solli një numër të madh të personave që merren me mbarështimin e zogjve, mendojmë që këte vit t'i mbështesim dhe të krijojmë mundesinë e një panairi në Shkodër, sepse edhe Shkodra është e njohur për një numër të madh ornitologësh (mbarështues zogjsh).

**ii. Synimi i projektit**

Rikthimi i traditës së ornitologjisë në Shkodër si dhe promovimi i territorit me anë të këtij panairi

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit ( Veprimet që do të ndermerrni për të prodhuar rezultate)**

- Konceptimi i panairit në të gjithë elementët e tij.
- Organizimi i aktivitetit me pjesëmarrjen e ornitologeve.
- Publikim i një materiali informativ me aktivitetet nga panairi.

**b) Rezultatet që prisni**

Rikthimi i traditës së Orintologjisë në qytetin e Shkodrës

| **c) Aktorët e mundshëm** | **d) Kontributet e mundshme në projekt** |
|---|---|
| Bashkia Shkodër<br>Shoqata e ornitologeve<br>Komuniteti | Bashkia e Shkodrës<br>Shoqata e ornitologeve |

**e) Shpenzimet e llogaritura**

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2018** | | Totali (mije lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Organizimi i aktivitetit. (Printime materialesh promocionale, transport, qera çadrash, foni, Dj, etj) | | | | 150 | | |
| | **Shuma** | **150** | | | **150** | | |

| | |
|---|---|
| **f) Periudha e zbatimit (kur fillon, kur përfundon)**<br>**2018**<br>**2019**<br>**2020** | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**<br>Drejtoria e Turizmit<br>Institucioni likujdues:Bashkia Shkoder |

| Nr.43 | **P6:F6:O3:A8.**<br>Aktiviteti "Lojra Popullore Fest" | **Llojet e programit: P6:** Zhvillimi ekonomik dhe i Turizmit: Funksioni<br><br>**P6:F6:** Turizëm |
|---|---|---|

**a) Pershkrimi i shkurtër i projektit**

**i. Situata**

"Lojra Popullore Fest" është një aktivitet me karakter social-kulturor për të rinjtë, i cili synon jo vetëm të pasurojë jetën e të rinjve por edhe ti njohë ata me traditat tona kombëtare me anën këngëve, valleve dhe lojrave popullore. Qëllimi i aktivitetit është të promovojë paqen, tolerancën, miqësinë në mes trupave pjesëmarrëse. "Lojra popullore fest" gjithashtu synon që të pasurojë jetën e të rinjve duke i angazhuar ato në identifikimin e vlerave njerëzore e vlerave folklorike kombëtare e ndërkombëtare. Vetë të rinjtë konkurojnë me performancat e tyre me lojra popullore, këngë e valle të traditave kombëtare dhe etnografike. Projekti nxit rininë për promovimin e vlerave turistike. Ky aktivitet i organizuar për të njëmbëdhjetin vit rradhazi, është kthyer në traditë për qytetin e Shkodrës. Këtë vit do ketë pjesëmarrje të fëmijëve nga gjithë territori i bashkisë. Ai do të realizohet në amfiteatrin natyror Ana e Malit, Oblikë, në fermën eko sociale.

**ii. Synimi i projektit**

- Të pasurojë jetën social kulturore të të rinjve.
- Të promovojë dhe t'i njohë ata me traditat e njësive administrative të Bashkisë Shkodër dhe me tej, me anë të performimeve të këngëve, valleve dhe lojrave popullore.
- Të përfshijë të gjithë njësitë administrative të Bashkisë së Shkodrës, nëpërmjet përfaqësimit nga të rinjtë e këtyre njësive.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit ( Veprimet që do të ndermerrni për të prodhuar rezultate)**

1. Përzgjedhja e trupave kandidate për pjesëmarrje
2. Ngritja e bashkëpunimit me trupat e përzgjedhura
3. Përgatitja e ambjentit ku do zhvillohet aktiviteti: skena, sigurimi i nevojave bazë.

*Procedura për zhvillimin e aktivitetit, do bëhet me thirrje publike, ku komisioni artistik do gjykojë projektin më të mirë.*

**b) Rezultatet që prisni**

Promovimi i vlerave dhe traditave kulturore të njësive administrative të Bashkisë së Shkodrës dhe angazhimi i të rinjve përmes një pjesmarrjeje të gjerë

| **c) Aktorët e mundshëm** | **d) Kontributet e mundshme në projekt** |
|---|---|
| Stafi i Bashkisë Shkodër ( Drejtoria e Turizmit; Drejtoria e Shërbimeve Sociale); Komuniteti, Institucione publike dhe OJF | Bashkia Shkodër;<br>DAR;<br>OJF |

**e) Shpenzimet e llogaritura**

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2018** | | Totali (mije lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Organizimi i aktivitetit. (Printime, baner, postera, transport materialesh dhe trupave pjesmarrësve, | | | | | 250 | |
| | **Shuma** | **250** | | | | 250 | |

| **f) Periudha e zbatimit (kur fillon, kur përfundon) 2018<br>2019<br>2020** | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**<br>Drejtoria e Turizmit<br>Institucioni likujdues:Bashkia Shkoder |
|---|---|

| Nr.45 | **P6:F6:O4:A2.** Aktiviteti “Termoizolim dhe blerje paisjesh per mobilimin e zyrave të informacionit turistik” | **Llojet e programit: P6:** Zhvillimi ekonomik dhe i Turizmit: Funksioni<br><br>**P6:F6:** Turizëm |
|---|---|---|

**a) Pershkrimi i shkurtër i projektit**

**i. Situata**

Zyra e informacionit turistik në Shkodër është vënë në funksion në muajin korrik të vitit 2017. Kjo zyrë është frekuentuar nga një numër i madh turistësh. Duke vlerësuar rëndësinë e kësaj zyre në dhënien e informacionit për orientimin e turistëvë që vizitojnë Shkodrën, është e domosdoshme që të krijohet një ambjent komod që të plotësojë të gjitha kushtet. Duhet që vetratat e xhamit të bëhen dopio-xham, gjithashtu dhe muret e jashtme të izolohen me material kundra shiut dhe erës.

**ii. Synimi i projektit**

Ofrimi i informacionit cilësor për turistët.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit ( Veprimet që do të ndermerrni për të prodhuar rezultate)**

1. Termoizolimi i ambjentit
2. Paisja e zyrës me infrastrukturën e duhur, për mirë funksionimin e saj.

**b) Rezultatet që prisni**

Përmirësimi i shërbimit ndaj vizitorit dhe i marketingut të territorit me anë të Zyrës së informacionit turistik në qytetin e Shkodrës.

| **c) Aktorët e mundshëm** | **d) Kontributet e mundshme në projekt** |
|---|---|
| Bashkia Shkodër.<br>Bizneset përfituese të turizmit. | Bashkia Shkodër |

**e) Shpenzimet e llogaritura**

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2018** | | Totali (mije lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A. 1 | Termoizolim për zyren e informacionit turistik | | | | | | 200 |
| A2 | Blerje paisjesh për mobilimin e zyrave të informacionit | | | | | | 100 |
| | **Shuma** | **300** | | | | | 300 |

| **f) Periudha e zbatimit (kur fillon, kur përfundon) 2018** | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**<br>Drejtoria e Turizmit<br>Institucioni likujdues:Bashkia Shkoder |
|---|---|

| | | |
|---|---|---|
| **Nr.50** | **P6:F6:O6:A2.**<br>Aktiviteti “Trajnime të guidave turistike që ushtrojnë aktivitetin në territorin e Shkodrës” | **Llojet e programit: P6:** Zhvillimi ekonomik dhe i Turizmit: Funksioni<br><br>**P6:F6:** Turizëm |

**a) Pershkrimi i shkurtër i projektit**

**i. Situata**

Në një turizëm bashkohor një tour guide ka një rol mjaft të rëndësishëm në shumë aspekte. Performanca e një tour guide matet nga kompetenca e tij, e cila varet gjithashtu nga trajnimi dhe të mësuarit. Trajnimi është një pjesë e rëndësishme për t'i dhënë çdo vizitori një eksperiencë të madhe dhe për të siguruar sigurinë e tyre. Është e rëndësishme për një destinacion turistik konkurrues që turistët të marrin shoqërinë e guidave turistike profesionale që i ndihmojnë ato me përvojat e tyre. Për këtë arsye lind nevoja për një trajnim më të specializuar të guidave turistike që ushtrojnë aktivitetin e tyre në qytetin e Shkodrës dhe përgatitja e tyre në marrjen e licencës për ushtrimin e këtij profesioni.

**ii. Synimi i projektit**

Trajnimi i guidave turistike me qëllim rritjen e kënaqësisë së eksperiencave turistike në qytetin e Shkodrës .

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit ( Veprimet që do të ndermerrni për të prodhuar rezultate)**

1. Përcaktimi i moduleve të trajnimit
2. Përzgjedhja e numrit të pjesmarrësve
3. Trajnim i guidave turistike me bizneset e sherbimeve turistike.
4. Pjesmarrja në aktivitete dhe seminare me tematikë turizmin

**b) Rezultatet që prisni**

Përmirësimi i performancës dhe profesionalizmit të guidave turistike.
Përgatitja e udhërrëfyesve turistik për certifikim

| **c) Aktorët e mundshëm** | **d) Kontributet e mundshme në projekt** |
|---|---|
| Bashkia Shkodër<br>Studentë të Universitetit të Shkodrës- Dega Turizëm<br>Punonjës të agjencive turistike | Bashkia Shkodër<br>Operatorë turistikë |

e) **Shpenzimet e llogaritura**

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2018** | | Totali (mije lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | | | | | 200 | | |
| | **Shuma** | **200** | | | 200 | | |

| | |
|---|---|
| **f) Periudha e zbatimit (kur fillon, kur përfundon)**<br>**2018** | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**<br>Drejtoria e Turizmit<br>Institucioni likujdues:Bashkia Shkoder |

| Nr.52 | **P6:F6:O7:A1.**<br><br>Vendosja e tabelave orientuese dhe informuese në Theth. | **Llojet e programit: P6:** Zhvillimi ekonomik dhe i Turizmit: Funksioni<br><br>**P6:F6:** Turizëm |
|---|---|---|

**a) Pershkrimi i shkurtër i projektit**

**i. Situata**

Zona e Thethit, e gjendur në zemër të Alpeve shqiptare përbën sot një ndër destinacionet më të frekuentuara të turizmit malor në Shqipëri. Ai frekuentohet nga një numër gjithnjë në rritje turistësh kryesisht europiano perëndimor të apasionuar pas ecjes në natyrë, alpinizmit, sporteve të aventurës por edhe thjeshtë kuriozë për mënyrën autentike të jetesës së banorëve të zonës. Brenda zonës së Thethit ka mjaft pika tërheqëse me interes për vizitorët të cilat vizitohen duke ecur në këmbë në shtigje që njihen nga guidat turistike të zonës. Këto shtigje është e nevojshme të jenë më të identifikuehme dhe të pajisen me sinjalistikë të përshtatshme, pasi ka një numër të madh vizitorësh të cilët vijnë në mënyrë të paorganizuar dhe pa guida turistike për të vizituar Thethin.

**ii. Synimi i projektit**

Përmirësimi i shërbimit dhe informacionit për vizitorët.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit ( Veprimet që do të ndërmerrni për të prodhuar rezultate)**

1. Mbledhja dhe sistemimi i informacionit për shtigjet ekzistuese.
2. Identifikimi i nevojave për ndërhyrje në shtigje për markimin e tyre dhe meremetimin e tyre aty ku ka nevojë.
3. Kryerja e punimeve
4. Botimi i një broshure informative.

**b) Rezultatet që prisni**

Markimi i shtigjeve dhe pajisja me sinjalistikën përkatëse e shtigjeve në Theth.

| **c) Aktorët e mundshëm** | **d) Kontributet e mundshme në projekt** |
|---|---|
| Bashkia Shkodër.<br>Dega e Turizmit të Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Shkodrës.<br>Banorët e zonës. | Bashkia Shkodër |

**e) Shpenzimet e llogaritura**

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2018** | | Totali (mije lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Vendosja e tabelave orientuese dhe informuese në Theth. | | | | | | 250 |
| | Shuma | 250 | | | | | 250 |

| **f) Periudha e zbatimit (kur fillon, kur përfundon) 2018 2020** | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**<br>Drejtoria e Turizmit<br>Institucioni likujdues:Bashkia Shkoder |
|---|---|

| Nr. 54 | **P6.F6.O7.A3.**<br>Vendosja e tabelave orientuese dhe informuese | **<u>Llojet e programit</u>: P6:** Zhvillimi ekonomik dhe i Turizmit<br><br>**Funksioni: P6:F6:** Turizëm |
|---|---|---|

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit**

**i. Situata**

Shkodra është kryeqendra nga mund të nisë udhëtimi për të vizituar veriperëndimin e Shqipërisë. Një numër i konsiderueshem i turistëve vinë në Shkodër në mënyrë të paorganizuar. Një rrjet i përhapur i informacionit lejon të arrihet shpejt dhe me siguri në destinacionin e dëshiruar. Prania e një shenje me drejtime të avancuara, shenja të konfirmimit dhe bordeve të informacionit është thelbësore për të arritur në destinacion pa mundim. Për këtë arsye, një zgjerim dhe përditësim i vazhdueshëm i tabelave orientuese dhe informuese, qofshin këto për automjete, biçikleta ose këmbësorë, është me rëndësi të madhe për të ofruar komoditetin e domosdoshem vizitorëve dhe udhëtarëve.

**ii. Synimi i projektit**

Përmirësimi i sinjalistikës dhe i informacionit turistik.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

1. Identifikimi i vendeve ku eshte e nevojshme vendosja e tabelave.
2. Percaktimi i llojit te tabelave.
3. Prodhimi dhe instalimi i tabelave.

**b) Rezultatet që prisni**

Atraksionet turistike lehtësisht të arritshme.

| **c) Aktorët e mundshëm** | **d) Kontributet e mundshme në projekt** |
|---|---|
| - Stafi i Bashkisë Shkodër<br>- Njësitë administrative<br>- Bizneset përfituese të turizmit. | Bashkia Shkodër |

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2018** | | Totali (mije lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1. | Vendosja e tabelave orientuese dhe informuese. | | | | | | 350 |
| | **Shuma** | **350** | | | | | **350** |

| **f) Periudha e zbatimit**<br>**2018**<br>**2019** | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**<br>Drejtoria e Turizmit<br>Institucioni likujdues:Bashkia Shkoder |
|---|---|

| Nr. 57 | **P6:F6:O7:A6.** Aktiviteti “Permiresim i aksesit se shpellës së Gajtanit nëpërmjet vënies në kushte sigurie të shtegut që të con në këtë shpellë.” | **Llojet e programit: P6:** Zhvillimi ekonomik dhe i Turizmit:<br>**Funksioni P6:F6:** Turizëm |
|---|---|---|

**a) Pershkrimi i shkurtër i projektit**

**i. Situata**

Shpella e Gajtanit është ndër monumentet natyrore më të veçanta në rajonin e Shkodrës për vlerat e saj shkencore (gjeomorfologjike, arkeologjike e speleologjike), didaktike e turistike . Përfaqëson një shpellë karstike të formuar në shkëmbinj gëlqerorë. Hyrja e saj është vertikale. Për të arritur një vizitueshmëri të madhe nga vizitorët vendas dhe të huaj, për shkak edhe të hyrjes se saj, është i rëndësishëm përmirësimi i aksesit të kësaj shpelle. Nevoja e herëpashershme për pastrim, mirëmbajtje, dhe vënie në kushte sigurie të shtegut që të orienton drejt kësaj shpelle mbetet ndër nevojat primare.

**ii. Synimi i projektit**

Përmirësimi i aksesit dhe i vizitueshmërisë në shpellën e Gajtanit.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit ( Veprimet që do të ndermerrni për të prodhuar rezultate)**

1. Analiza e gjendjes faktike
2. Pastrimi i vegjetacionit.
3. Sistemim dhe mirëmbajtje e shtegut dhe hyrjes së shpellës.

**b) Rezultatet që prisni**

Rritja e numrit të vizitorëve vendas dhe të huaj në të gjithë zonën.

| **c) Aktorët e mundshëm** | **d) Kontributet e mundshme në projekt** |
|---|---|
| AKZM,<br>Njesia amdministrative Gur i Zi,<br>Drejtoria e Studimeve,Planifikimit, Koordinimit dhe Monitorimit te Investimeve. | Bashkia Shkodër |

e) Shpenzimet e llogaritura

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2018** | | Total i (mije lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Rikonstruksion i aksesit te hyrjes së shpellës. | | | | | | 400 |
| | **Shuma** | **400** | | | | | **400** |

| **f) Periudha e zbatimit (kur fillon, kur përfundon) 2018** | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**<br>Drejtoria e Turizmit<br>Institucioni likujdues:Bashkia Shkoder |
|---|---|

| Nr.58 | **P6.F6.O7.A8**<br>Bashkëfinancim për projektin: "Rigjenerimi i zonës së mbrojtur të Liqenit të Shkodrës përmes forcimit të qeverisjes lokale" | **Llojet eprogramit: P6:** Zhvillimiekonomikdhe iTurizmit:<br><br>**Funksioni**: **P6:F6:** Turizëm |
|---|---|---|

**a) Pershkrimi shkurtëri projektit**

**i. Situata**

Liqeni i Shkodrës është liqeni më i madh në Gadishullin Ballkanik dhe llogaritet si një nga liqenet më të vjetra në botë.Vetëm gjashte metra mbi nivelin e detit me një sipërfaqe prej 368 km². 149 km² prej tyre me gjatësi brigjesh prej 57 km i përkasin Republikës së Shqipërisë; kurse 2/3 e tij i përket Malit të Zi. Liqeni i Shkodrës është i njohur për shumëllojshmëri të faunës dhe i pasur me 45 lloje peshqish e 270 lloje shpendësh. Vlerat turistike të liqenit janë të mëdha, pasi aty ka një harmonizim të përkryer të terreneve malore, fushore e ujore, që i japin kësaj zone një pamje piktoreske.Vitet e fundit marrëdhënia njeri-ujë ka ndryshuar.Presioni është gjithmonë në rritje dhe në këtë mënyrë liqeni rrezikohet nga shumë faktorë. Për këtëështë menduar që përvec aktiviteteve për ndërgjegjësimin dhe përfshirjen e komunitetit, të bëhen dhe disa ndërhyrje pilot për nxitjen e zhvillimit të turizmit të qëndrueshëm në këtë zonë.

**ii. Synimi i projektit**

- Fuqizimi i masave për ruajtjen e habitat-it në zonën e Liqenit të Shkodrës
- Nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm të aktiviteteve ekonomike të lidhura me turizmin nepërmjet një *governance* lokale të përmirësuar.

Fuqizimi i masave për ruajtjen e habitat-it në Zonën e Liqenit të Shkodrës dhe nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm të aktiviteteve ekonomike të lidhura me turizmin nepërmjet një *governance* lokale të përmirësuar.

**iii. Aktivitetetkryesore tëprojektit ( Veprimetqëdotëndermerrnipërtëprodhuar rezultate)**

**A.1 Përfshirja e komunitetit dhe autoriteteve lokale në *governance* e ZM – Liqeni i Shkodrës.**
A.1.1 Krijimi i *Komitetit Drejtues* të projektit.
A.1.2 Vizitë studimore e delegacionit shqiptar në Itali: përvojat e zhvillimit dhe mbrojtjes territoriale të Comune di Sauris.

**A.2 Projektimi i ndërhyrjeve pilot:**
A.2.1 Identifikimi i udhëzimeve për zhvillimin e turizmit si dhe mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit.
A.2.2 Ëorkshop ndërkombëtar për projektimin arkitektonik dhe programimin funksional të zonave pilot në Shqipëri: studentët e Universitetit të Arkitekturës së Triestes dhe studentët e Fakultetit të Ekonomisë në Universitetin e Shkodrës (dega Turizëm) do të bashkëpunojnë në identifikimin e mundësive të reja për zhvillimin e shërbimeve të reja turistike në liqen, në bazë të udhëzimeve të identifikuara.
A.1.3 Nisja e bashkëveprimit me institucionet dhe komunitetin lokal për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin ekonomik.

**A.3 Realizimi i ndërhyrjeve në strukturat që gjenden në zonën e Bajzës (Syri Shegani) dhe në Shirokë/Zogaj dhe nisja e projektit pilot për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm në Liqenin e Shkodrës.**
A.3.1 Përpunimi dhe publikimi i thirrjes për administrimin publik/privat të shërbimeve në mbështetje të turizmit të qëndrueshëm në Zonën e Mbrojtur – Liqeni i Shkodrës.
A.3.2 Seleksionimi i propozimeve nga ana e përfaqësuesve të Bashkive, AKZM, Oxfam Italia dhe Kallipolis.
A.3.3 Trajnimi i përfituesve.
A.3.4 Projektimi i ndërhyrjeve dhe realizimi.
A.3.5 Nisja e shërbimeve turistike.

**A.4 Ndërgjegjësimi**
A.4.1 Takime me shkollat të organizuara pranë strukturave të liqenit.
A.4.2 Vizita trajnuese të organizuara me përfaqësuesit e shoqatave dhe specialistë të administratës publike.
A.4.3 Publikimi i punimeve të ëorkshop-it ndërkombëtar.
A.4.4 Aktivitete ndërgjegjësimi në Rajonin Friulia Venezia Giulia.

**b)Rezultatet që prisni**

**Rezultati i pritshëm 1** – Qeverisje e përmirësuar e Zonës së Mbrojtur – Liqeni i Shkodrës.
**Rezultati i pritshëm 2** – Zhvillimi turistik i Zonës së Mbrojtur – Liqeni i Shkodrës i përmirësuar.
**Rezultati i pritshëm 3** – Ndikimi mjedisor i komuniteteve lokale rezidente dhe i turistëve në Zonën e Mbrojtur – Liqeni i Shkodrës.
**Rezultati i pritshëm 4** – Aktorët kryesorë dhe popullsia shqiptare e ndërgjegjësuar mbi temat mjedisore.

| **c)Aktorët e mundshëm** | **d)Kontributet emundshmenëprojekt** |
|---|---|

| | |
|---|---|
| Kallipolis (partner kryesor)<br>Departamenti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës, Universiteti i Triestes<br>Comune di Sauris / UTI Carnia<br>Agjencia Rajonale për Mbrojtjen e Mjedisit e Friuli Venezia Giulia (ARPA)<br>Oxfam Italia<br>Bashkia Malësi e Madhe<br>Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM)<br>Fakulteti i Ekonomisë, dega Turizëm – Universiteti i Shkodrës | Bashkia Shkodër 18 %<br><br>(60% financim i Reggione Autonoma ( Friuli Venezia Giulia dhe 40% financim i partnerëve Bashkia Shkoder, Callipolis, Departamenti i Inxhinierise dhe Arkitetktures universiteti i Triestes. Comune Sauris Itali, Agjensia Rajonale e Mbrojtjes Mjedisit FVG, OXFAM Italia. Bashkia Malesi e Madhe, AKZM, Fakulteti Ekonomik, Dega Turizem Universiteti i Shkoderes) |

e) Shpenzimet e llogaritura

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2018** | | Totali (mije lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A. 1 | Bashkefinancim | | | | | | |
| | **Shuma** | 600 | | | | 600 | |

| | |
|---|---|
| **f) Periudha e zbatimit (kur fillon, kur përfundon):**<br>**2018-2019 (18 muaj)** | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**<br>Drejtoria eTurizmit<br>Institucioni likujdues:Bashkia Shkoder |